



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së
Z. EDI RAMA

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Z. BLENDI KLOSI

**PLANI I DETAJUAR I ZONËS ME RËNDËSI KOMBËTARE (PDZRK)
VJOSË-NARTË, BASHKIA VLORË**

PLANI I DETAJUAR I ZHVILLIMIT

Miratur me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. __, Datë __.__.2021

Hartuar nga

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT)



3 Tabela e përmbajtjes

4	1. Nevoja për hartimin e PDZRK-së, Qëllimi dhe Objektivat	6
	1.2. Përmbajtja e PDZRK-së	7
	1.3. Kufiri i PDZRK-së	7
5	2. Baza ligjore	12
	2.1 Legjislacioni	12
	2.2 Dokumente planifikimi në fuqi	13
	2.2.1 PPKT - Plan i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit	14
	2.2.2 Zona e Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë - Nartë”	17
	2.2.3. Plan i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar	20
	2.2.4 Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë	21
3.	Permbledhje e Analizes dhe Strategjise Territoriale	25
	3.1. Analiza e pronësisë	25
	3.2. 3.2 Aksesit dhe infrastruktura lidhese	28
	3.3. Analiza e zhvillimeve ekzistuese (ndërtesat, lartësitë e kateve, intensiteti, ksht, cilësia e ndërtimeve).....	31
	3.4. Profili demografik.....	32
	3.5. Ekonomia lokale	32
	3.6. Analiza e sizmike	36
4.	Gjendja mjedisore.....	40
	4.1. Klima, erërat, diellëzimi dhe rreshjet.....	40
	4.2. Gjeomorfologjia	41
	4.3. Hidrologjia	42
	4.4. Rreziqet	44
5.	Biodiversiteti	44
6.	Konkluzione mbi analizën e zones	47
6.1	Vështrim i përgjithshëm.....	47
6.2	Sistemi ujor	48
6.3	Sistemi i gjelbërt, natyror.....	49
6.4	Propozimet territoriale	50
6.5	Përdorimi i propozuar i tokës dhe ndarja e njësive në nënnjësi.....	51
	6.7.1 Sistemet bazë të territorit	52

6.7.2.	Përdorimi i tokës sipas njësive strukturore	55
Njësité strukturore të sistemit Bujqësor		55
Të gjitha njësité e sistemit bujqësor, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë.....		
Njësité strukturore të Sistemit Natyror.....		55
Njësité strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike.		55
6.7.3.	Plani i infrastrukturave teknike.....	58
6.7.4.	Infrastruktura rrugore.....	59
6.7.5.	Infrastruktura e ujësjellësit.....	64
6.7.6.	Infrastrukturat e kanalizimeve dhe ujërave të ndotur dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta	65
6.7.7.	Infrastrukturat e enegjisë elektrike dhe të teknologjisë së informacionit	67
6.8	Plani i mbrojtjes së peizazhit	68
6.9	Plani i veprimit për zbatimin e planit të detajuar - ndërtimi i infrastrukturave dhe shërbimeve publike.....	70

Lista e Hartave

Harta 1. Kufiri i PDZRK-së në raport me qytetin e Vlorës.....	11
Harta 2. Zonimi i brendshëm i peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë.....	18
Harta 3. Habitatet e ndryshme të Peizazhit të mbrojtur Vjosë-Nartë	18
Harta 4 Territori i PDZRK-së në raport me Zonën e Mbrojtur.....	19
Harta 5 pretendimet e pronësise, Burimi: ASHK, 2019	26
Harta 6 e zonave kadastrale. Burimi; ASIG, 03/2020	27
Harta 7. Harta e infrastrukturës lidhëse, PPV Vlorë.....	30
Harta 8 Rrjeti i ujërave mbitokësore, zona Vjosë Nartë, Burimi:MTM “Peisazhi i Mbrojtur “Vjosë-Nartë”	43
Harta 9 Vegetacioni në zonën Vjosë Nartë, Burimi:MTM “Peisazhi i Mbrojtur “Vjosë-Nartë”	45
Harta 10. Harta e Sistemeve Bazë të territorit.....	Error! Bookmark not defined.
Harta 11. Harta e Përdorimit të propozuar të tokës	Error! Bookmark not defined.
Harta 12. Infrastruktura rrugore e propozuar	64

Lista e Tabelave

Tabela 1 Siperfaqja e pershkruar dhe e djegur e pronave ne PM Vjosë-Nartë	44
Tabela 2 Njësitë strukturore të Sistemeve mikes Bujqësi dhe Natyrë	
Tabela 1 Njësitë strukturore të Sistemit Urban, Shërbime dhe Aktivitete Shqërore dhe Argëtimi	
Tabela 3 Njësitë strukturore të Sistemit Urban, Banim	
Tabela 3 Njësitë strukturore të Sistemit Infrastrukturor	
Tabela 3 Njësitë strukturore të Sistemit Bujqësor	

Lista e AKRONIMEVE

AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
PDZRK	Plan i Detajuar për zonë të Rëndësisë Kombëtare
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar Shqipëria 2030
PINS Bregdeti	Plani i Integruar Ndersektorial i Bregdetit
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
NO	Novoselë
KSHT	Koeficienti i Shfrytëzimit të Tokës
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

4 1. Nevoja për hartimin e PDZRK-së, Qëllimi dhe Objektivat

1.1. Nevoja për hartimin e PDZRK-së. Qëllimi dhe objektivat

Hartimi i një Plani të Detajuar për Zonë me Rëndësi Kombëtare përmbush realizimin e hallkave të planifikimit midis instrumentave kombëtar dhe atyre strategjike për zhvillimin e territorit. Një plan i tillë hartohet bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave me rëndësi kombëtare.

Hartimi i PDZRK-së për zonën Vjosë- Nartë, Bashkia Vlorë kryhet me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe përbën një detyrim ligjor në bazë të përcaktimeve të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe VKM-së Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, Neni 32 i së cilës përcakton se:

- *Zhvillimi i zonave të rëndësishme kombëtare në përputhje me kufizimet dhe kushtëzimet e legjislacionit sektorial, kryhet nëpërmjet lejeve të ndërtimit, në territore me kushte zhvillimi të paracaktuara si rezultat i proceseve të planifikimit të territorit;*
- *Kur zhvillimi propozohet në zona të paurbanizuara, territori përkatës pjesë e zones së rëndësishme kombëtare duhet t'i nënshtrohet detyrimit një planifikimi të detajuar e të posatshtëm.*
- *Ky proces planifikimi kryhet nëpërmjet hartimit të Planit të Detajuar të Zonës me Rëndësi Kombëtare.*

Plani i Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”, gjithashtu e ka përcaktuar territorin e këtij studimi si zonë të rëndësishme kombëtare, ref. Harta “Potenciali Turistik”, VKM nr.881, datë 14.12.2016. Gjithashtu, përcaktimi për hartimin e PDZRK-së në Nartë, shprehet nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vloë, miratuar me Vendim të KKT Nr. 01, datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vlorë”.

PDZRK hartohet në zbatim të orientimeve strategjike të Planit Kombëtar Sektorial për Bregdetin, dhe detajon përcaktimet për zhvillime në funksion të turizmit bregdetar në zonën e Vlorë-Nartës.

Sipas legjislacionit të sipërcituar në fushën e planifikimit të territorit, PDZRK qëndron në hierarkinë e planifikimit nën Planet Kombëtare Sektoriale, dhe mbi Planet e Përgjithshme Vendore. Si i tillë, PDZRK merr parasysh parashikimet e PPV-në e Bashkisë Vlorë, në këtë rast, por rezervon të drejta për të rishikuar propozimet e PPV-së, në zbatim të vizionit të PKST të Bregdetit për zhvillimin turistik në rajon.

Qëllimi i PDZRK-së është përcaktimi i qartë i kushteve për zhvillim të cilat do të sigurojnë një balancë të drejtë midis interesit privat dhe publik në zhvillimin e turizmit, ruajtjen e vlerave mjedisore dhe karakteristikat e peisazhit bregdetar e lagunor të zonës. Në themel të këtij procesi qëndron bashkërendimi ndërsektorial, koordinimi institucional si edhe zbatimi i detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dokumentat e planifikimit në fuqi, për territorin subjekt zhvillimi. Gjithashtu, ky plan synon të sigurojë që zhvillimi turistik i propozuar, të ndjekë një rrugë vërtet të qëndrueshme dhe që kontribuon në një menaxhim të cilësor të zonës së mbrojtur, territorit publik dhe private, siguron bashkëpunim të zgjeruar dhe partneritet konkrete midis industrisë së

turizmit dhe qeverisjes në të gjitha nivelet duke kontribuar njëkohësisht në mirëqenien e komunitetit lokal.

Objektivat kryesor të PDZRK për zonën e Nartës mund të përmbliken si më poshtë:

- Të sigurojë mundësi për realizimin e strukturave zhvillimore të cilat respektojnë karakteristikast mjedisore, peisazhin dhe kapacitetin mbajtës për zonën.
- Të sigurojë një proces transparent të ndarjes së njësive në në nënjësi strukturore pas riorganizimit të parcelave (përmes ndarjes dhe/ose ribashkimit) me qëllim përmirësimin e mundësive për investim
- Detajimet për brezat mbrojtës të vijave ujorë, gjerësia e brezave të gjelbërimit dhe të akseve-korridoreve të kalimit
- Përcaktimi i kushteve dhe rregullave teknike për zbatimin e strukturave dhe infrastrukturës mbështetëse me qëllim ruajtjen e bregut dhe të burimeve ujore në zonë.

1.2. Përmbajtja e PDZRK-së

Plani i Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare të Nartës, Bashkia Vlorë, përmban dokumentet e nevojshme në përputhje me VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar:

- Në përputhje me nenin 37 të Rregullores së Planifikimit, për këtë PDZRK hartohet vetëm **Faza III**, pasi fazat I dhe II tejkalohen, duke qënë se përmbajtja e tyre është e plotësuar nga dokumente të mbivendosura planifikimi në fuqi: PINS Bregdeti dhe PPV Vlorë. Nisur nga konteksti natyror i zonës në studim, pjesë e një zonë të mbrojtur, nevojitet që PDZRK të shoqërohet edhe me Vlerësimin Strategjik Mjedisor të detajuar për këtë territor dhe zhvillimet e parashikuara nga plani.
- Kështu, **PDZRK do të përmbajë** dokumentet e hartimit të Fazës III:
 1. Planin e Detajuar të Zhvillimit;
 2. Rregulloren e Detajuar të Planit;
 3. Hartat shoqëruese;
 4. Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
 5. Paketa e të dhënave në GIS, në përputhje me standardin e Regjistrat Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

1.3. Kufiri i PDZRK-së

Territori objekt i këtij studimi është pjesë e Bashkisë Vlorë, referuar kufijve administrativ territorial të miratuar me VKM Nr. 360 datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativë-territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore", në zbatim të Ligjit Nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Territori subjekt i PDZRK-së shtrihet në Veri të qytetit të Vlorës dhe bën pjesë në:

- Pejzazhin e mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartës, Zonë e Mbrojtur të Rëndësisë Kombëtare, miratuar me VKM Nr. 680, datë 22.10.2004, “Për shpalljen e sistemit

ligatinor Vjosë-Nartë peizazh ujor/tokësor i mbrojtur”

- Brezin Bregdetar, Zonë e Rëndësisë Kombëtare, miratuar me VKM Nr. 881, datë 14.12.2016, “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”.

Subjekt i PDZRK-së do të jenë 197 njësi strukturore:

- | | |
|--|---|
| 1. Njësia NO.B.10, me sipërfaqe 6.74 ha | 101. Njësia NO.UB.4.641, me sipërfaqe 0.30 ha |
| 2. Njësia NO.B.150, me sipërfaqe 8.65 ha | 102. Njësia NO.UB.4.642, me sipërfaqe 0.81 ha |
| 3. Njësia NO.B.151, me sipërfaqe 7.73 ha | 103. Njësia NO.UB.4.643, me sipërfaqe 0.03 ha |
| 4. Njësia NO.B.1513, me sipërfaqe 29.95 ha | 104. Njësia NO.UB.4.644, me sipërfaqe 0.80 ha |
| 5. Njësia NO.B.1516, me sipërfaqe 1 ha | 105. Njësia NO.UB.5.461, me sipërfaqe 2.79 ha |
| 6. Njësia NO.B.1517, me sipërfaqe 1427.57 ha | 106. Njësia NO.UB.5.636, me sipërfaqe 21.12 ha |
| 7. Njësia NO.B.1518, me sipërfaqe 51.96 ha | 107. Njësia NO.UB.5.637, me sipërfaqe 1.40 ha |
| 8. Njësia NO.B.1520, me sipërfaqe 15.53 ha | 108. Njësia NO.UB.5.638, me sipërfaqe 0.28 ha |
| 9. Njësia NO.B.1521, me sipërfaqe 903.28 ha | 109. Njësia NO.UB.5.639, me sipërfaqe 0.02 ha |
| 10. Njësia NO.B.1525, me sipërfaqe 407.87 ha | 110. Njësia NO.UB.6.1145, me sipërfaqe 5.06 ha |
| 11. Njësia NO.B.1526, me sipërfaqe 199.25 ha | 111. Njësia NO.UB.6.1161, me sipërfaqe 16.68 ha |
| 12. Njësia NO.B.153, me sipërfaqe 139.46 ha | 112. Njësia NO.UB.6.1162, me sipërfaqe 21.72 ha |
| 13. Njësia NO.B.166, me sipërfaqe 0.12 ha | 113. Njësia NO.UB.6.1684, me sipërfaqe 3.50 ha |
| 14. Njësia NO.B.167, me sipërfaqe 1260.28 ha | 114. Njësia NO.UB.6.1685, me sipërfaqe 3.09 ha |
| 15. Njësia NO.B.168, me sipërfaqe 3.10 ha | 115. Njësia NO.UB.6.633, me sipërfaqe 0.41 ha |
| 16. Njësia NO.B.173, me sipërfaqe 1.34 ha | 116. Njësia NO.UB.6.634, me sipërfaqe 1.17 ha |
| 17. Njësia NO.B.174, me sipërfaqe 88.82 ha | 117. Njësia NO.UB.6.635, me sipërfaqe 0.46 ha |
| 18. Njësia NO.B.18, me sipërfaqe 31.14 ha | 118. Njësia NO.UB.6.747, me sipërfaqe 0.22 ha |
| 19. Njësia NO.B.456, me sipërfaqe 25.38 ha | 119. Njësia NO.UB.6.873, me sipërfaqe 0.98 ha |
| 20. Njësia NO.B.457, me sipërfaqe 9.83 ha | 120. Njësia NO.UB.7.660, me sipërfaqe 4.51 ha |
| 21. Njësia NO.B.458, me sipërfaqe 9.59 ha | 121. Njësia NO.UB.7.661, me sipërfaqe 14.42 ha |
| 22. Njësia NO.B.459, me sipërfaqe 3.78 ha | 122. Njësia NO.UB.7.662, me sipërfaqe 0.50 ha |
| 23. Njësia NO.B.460, me sipërfaqe 4.65 ha | 123. Njësia NO.UB.7.663, me sipërfaqe 0.01 ha |
| 24. Njësia NO.B.462, me sipërfaqe 6.12 ha | 124. Njësia NO.UB.8.664, me sipërfaqe 14.21 ha |
| 25. Njësia NO.B.463, me sipërfaqe 1.92 ha | 125. Njësia NO.UB.8.665, me sipërfaqe 0.23 ha |
| 26. Njësia NO.B.464, me sipërfaqe 9.68 ha | 126. Njësia NO.UB.8.666, me sipërfaqe 0.08 ha |
| 27. Njësia NO.B.465, me sipërfaqe 21.96 ha | 127. Njësia QE.B.133, me sipërfaqe 4.73 ha |
| 28. Njësia NO.B.497, me sipërfaqe 178.87 ha | 128. Njësia QE.B.134, me sipërfaqe 62.18 ha |
| 29. Njësia NO.B.498, me sipërfaqe 63.79 ha | 129. Njësia QE.B.135, me sipërfaqe 40.23 ha |
| 30. Njësia NO.B.56, me sipërfaqe 136.99 ha | 130. Njësia QE.B.136, me sipërfaqe 28.03 ha |
| 31. Njësia NO.B.8, me sipërfaqe 17.32 ha | 131. Njësia QE.B.141, me sipërfaqe 0.01 ha |
| 32. Njësia NO.B.9, me sipërfaqe 28.79 ha | 132. Njësia QE.B.238, me sipërfaqe 1.48 ha |
| 33. Njësia NO.IN.188, me sipërfaqe 6.41 ha | 133. Njësia QE.B.34, me sipërfaqe 105.86 ha |
| 34. Njësia NO.IN.189, me sipërfaqe 0.75 ha | 134. Njësia QE.B.489, me sipërfaqe 0.22 ha |
| 35. Njësia NO.IN.190, me sipërfaqe 0.07 ha | 135. Njësia QE.B.84, me sipërfaqe 196.96 ha |
| 36. Njësia NO.IN.193, me sipërfaqe 1.43 ha | 136. Njësia QE.IN.17, me sipërfaqe 0.51 ha |
| 37. Njësia NO.IN.194, me sipërfaqe 0.97 ha | 137. Njësia QE.IN.186, me sipërfaqe 1.91 ha |
| 38. Njësia NO.IN.195, me sipërfaqe 0.55 ha | 138. Njësia QE.IN.197, me sipërfaqe 1.20 ha |
| 39. Njësia NO.IN.196, me sipërfaqe 26.46 ha | 139. Njësia QE.IN.257, me sipërfaqe 0.47 ha |
| 40. Njësia NO.IN.24, me sipërfaqe 307.60 ha | 140. Njësia QE.N.1561, me sipërfaqe 1.21 ha |
| 41. Njësia NO.N.102, me sipërfaqe 32.44 ha | 141. Njësia QE.N.1565, me sipërfaqe 3.89 ha |

42. Njësia NO.N.107, me sipërfaqe 8.25 ha
43. Njësia NO.N.108, me sipërfaqe 1.15 ha
44. Njësia NO.N.149, me sipërfaqe 5.88 ha
45. Njësia NO.N.1512, me sipërfaqe 19.09 ha
46. Njësia NO.N.1519, me sipërfaqe 6.81 ha
47. Njësia NO.N.1527, me sipërfaqe 30.40 ha
48. Njësia NO.N.1593, me sipërfaqe 139.82 ha
49. Njësia NO.N.169, me sipërfaqe 7.70 ha
50. Njësia NO.N.170, me sipërfaqe 21.56 ha
51. Njësia NO.N.171, me sipërfaqe 108.81 ha
52. Njësia NO.N.176, me sipërfaqe 227.41 ha
53. Njësia NO.N.178, me sipërfaqe 6.90 ha
54. Njësia NO.N.225, me sipërfaqe 10.41 ha
55. Njësia NO.N.226, me sipërfaqe 10.02 ha
56. Njësia NO.N.227, me sipërfaqe 10.09 ha
57. Njësia NO.N.44, me sipërfaqe 39.24 ha
58. Njësia NO.N.62, me sipërfaqe 41.70 ha
59. Njësia NO.N.63, me sipërfaqe 37.83 ha
60. Njësia NO.N.65, me sipërfaqe 649.25 ha
61. Njësia NO.N.78, me sipërfaqe 968.93 ha
62. Njësia NO.N.80, me sipërfaqe 416.72 ha
63. Njësia NO.U.100, me sipërfaqe 31.63 ha
64. Njësia NO.U.101, me sipërfaqe 62.70 ha
65. Njësia NO.U.103, me sipërfaqe 274.31 ha
66. Njësia NO.U.142, me sipërfaqe 765.40 ha
67. Njësia NO.U.1514, me sipërfaqe 10.82 ha
68. Njësia NO.U.1515, me sipërfaqe 12.08 ha
69. Njësia NO.U.1522, me sipërfaqe 11.03 ha
70. Njësia NO.U.1523, me sipërfaqe 13.34 ha
71. Njësia NO.U.1524, me sipërfaqe 16.08 ha
72. Njësia NO.U.1528, me sipërfaqe 6.11 ha
73. Njësia NO.U.172, me sipërfaqe 46.14 ha
74. Njësia NO.U.177, me sipërfaqe 16.96 ha
75. Njësia NO.U.87, me sipërfaqe 116.32 ha
76. Njësia NO.U.88, me sipërfaqe 28.32 ha
77. Njësia NO.U.90, me sipërfaqe 28.47 ha
78. Njësia NO.U.91, me sipërfaqe 1994.38 ha
79. Njësia NO.U.94, me sipërfaqe 1563.06 ha
80. Njësia NO.U.96, me sipërfaqe 27.50 ha
81. Njësia NO.U.97, me sipërfaqe 24.41 ha
82. Njësia NO.UB.1.654, me sipërfaqe 12.79 ha
83. Njësia NO.UB.1.655, me sipërfaqe 1.04 ha
84. Njësia NO.UB.1.656, me sipërfaqe 0.19 ha
85. Njësia NO.UB.1.657, me sipërfaqe 0.26 ha
86. Njësia NO.UB.1.658, me sipërfaqe 0.02 ha
87. Njësia NO.UB.1.659, me sipërfaqe 0.38 ha
142. Njësia QE.N.1612, me sipërfaqe 8.60 ha
143. Njësia QE.N.1613, me sipërfaqe 7.86 ha
144. Njësia QE.N.19, me sipërfaqe 118.82 ha
145. Njësia QE.N.209, me sipërfaqe 26.59 ha
146. Njësia QE.N.224, me sipërfaqe 4.13 ha
147. Njësia QE.N.228, me sipërfaqe 2.04 ha
148. Njësia QE.N.229, me sipërfaqe 5.92 ha
149. Njësia QE.N.230, me sipërfaqe 1.32 ha
150. Njësia QE.N.231, me sipërfaqe 1.90 ha
151. Njësia QE.N.232, me sipërfaqe 4.68 ha
152. Njësia QE.N.233, me sipërfaqe 3.91 ha
153. Njësia QE.N.234, me sipërfaqe 2.83 ha
154. Njësia QE.N.235, me sipërfaqe 6.20 ha
155. Njësia QE.N.236, me sipërfaqe 3.26 ha
156. Njësia QE.N.237, me sipërfaqe 2.69 ha
157. Njësia QE.N.239, me sipërfaqe 12.36 ha
158. Njësia QE.N.242, me sipërfaqe 36 ha
159. Njësia QE.N.243, me sipërfaqe 0.09 ha
160. Njësia QE.N.254, me sipërfaqe 14.25 ha
161. Njësia QE.N.258, me sipërfaqe 4.10 ha
162. Njësia QE.N.259, me sipërfaqe 0.51 ha
163. Njësia QE.N.503, me sipërfaqe 120.48 ha
164. Njësia QE.U.104, me sipërfaqe 43.07 ha
165. Njësia QE.U.105, me sipërfaqe 96.12 ha
166. Njësia QE.U.106, me sipërfaqe 33.70 ha
167. Njësia QE.U.118, me sipërfaqe 11.34 ha
168. Njësia QE.U.1562, me sipërfaqe 0.01 ha
169. Njësia QE.U.1563, me sipërfaqe 0.96 ha
170. Njësia QE.U.1564, me sipërfaqe 7.63 ha
171. Njësia QE.U.1566, me sipërfaqe 44.22 ha
172. Njësia QE.U.1567, me sipërfaqe 39.95 ha
173. Njësia QE.U.208, me sipërfaqe 1.30 ha
174. Njësia QE.U.92, me sipërfaqe 37.52 ha
175. Njësia QE.U.93, me sipërfaqe 84.42 ha
176. Njësia QE.U.95, me sipërfaqe 12.18 ha
177. Njësia QE.UB.11.731, me sipërfaqe 27.17 ha
178. Njësia QE.UB.11.749, me sipërfaqe 0.75 ha
179. Njësia QE.UB.11.830, me sipërfaqe 0.04 ha
180. Njësia QE.UB.11.831, me sipërfaqe 0.10 ha
181. Njësia QE.UB.11.832, me sipërfaqe 0.07 ha
182. Njësia QE.UB.12.1180, me sipërfaqe 0.87ha
183. Njësia QE.UB.12.730, me sipërfaqe 1.88 ha
184. Njësia QE.UB.12.810, me sipërfaqe 1.19 ha
185. Njësia QE.UB.12.817, me sipërfaqe 0.92 ha
186. Njësia QE.UB.12.857, me sipërfaqe 2.51 ha
187. Njësia QE.UB.12.858, me sipërfaqe 1.22 ha

88. Njësia NO.UB.11.684, me sipërfaqe 5.56 ha
 89. Njësia NO.UB.2.650, me sipërfaqe 0.35 ha
 90. Njësia NO.UB.2.651, me sipërfaqe 0.75 ha
 91. Njësia NO.UB.2.652, me sipërfaqe 0.01 ha
 92. Njësia NO.UB.2.653, me sipërfaqe 3.75 ha
 93. Njësia NO.UB.2.845, me sipërfaqe 18.84 ha
 94. Njësia NO.UB.3.1151, me sipërfaqe 0.25 ha
 95. Njësia NO.UB.3.645, me sipërfaqe 0.42 ha
 96. Njësia NO.UB.3.646, me sipërfaqe 0.76 ha
 97. Njësia NO.UB.3.647, me sipërfaqe 33.24 ha
 98. Njësia NO.UB.3.648, me sipërfaqe 0.99 ha
 99. Njësia NO.UB.3.649, me sipërfaqe 3.43 ha
 100. Njësia NO.UB.4.640, me sipërfaqe 34.78 ha

188. Njësia QE.UB.12.859, me sipërfaqe 17.52 ha
 189. Njësia QE.UB.13.1568, me sipërfaqe 2.96 ha
 190. Njësia QE.UB.13.1569, me sipërfaqe 2.97 ha
 191. Njësia QE.UB.13.784, me sipërfaqe 0.01 ha
 192. Njësia QE.UB.13.828, me sipërfaqe 5.96 ha
 193. Njësia QE.UB.13.829, me sipërfaqe 5.72 ha
 194. Njësia QE.UB.13.863, me sipërfaqe 0.07 ha
 195. Njësia QE.UB.13.864, me sipërfaqe 1.93 ha
 196. Njësia QE.UB.14.860, me sipërfaqe 0.28 ha
 197. Njësia QE.UB.14.861, me sipërfaqe 1.19 ha

Këto njësi janë përkufizuar fillimisht në PPV Vlorë, dhe do të studiohen në nivel të detajuar nga PDZRK. Në tërësi, territori subjekt i PDZRK-së ka një sipërfaqe prej **2,083.22 ha**, i përkufizuar sipas hartës nr. 1.





Figura 1 Vendndodhja e zonës në studim



5 2. Baza ligjore

2.1 Legjislacioni

Baza ligjore kryesore për hartimin e *Planit të Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare për zonën e Nartës, në Veri të qytetit të Vlorës*, mbështetet në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar.

Përgatitja e PDZRK-së, jo vetëm që do të përmbushë një detyrim të rëndësishëm ligjor, duke plotësuar hierarkinë e dokumentave të planifikimit, por do të sigurojë hartimin dhe zbatimin e parametrave të ndertimit dhe perdorimit të tokës që sigurojnë zhvillimin e qëndrueshëm të zonës në fjalë. Më poshtë janë renditur aktet ligjore që përbëjnë kuadrin ligjor në fuqi në fushën e planifikimit të territorit si dhe atë sektorial të detyrueshëm për t'u zbatuar gjatë procesit të hartimit të PDZRK-së:

Nr.	Nr./Datë e Aktit ligjor	Titulli i aktit ligjor
1	Ligji Nr. 107/2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar
2	Ligji Nr. 81/2017	“Për zonat e mbrojtura”
3	Ligji Nr. 93/2015	“Për Turizmin”, i ndryshuar
4	Ligji Nr. 55/2015	“Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
5	Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006	"Për mbrojtjen e biodiversitetit", i ndryshuar
6	Ligji Nr. 111/2012	“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar
7	Ligji Nr. 27/2018	“Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”
8	VKM Nr. 686, datë 22.11.2017	“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar
9	VKM Nr. 408, datë 13.05.2015	“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar
10	VKM Nr. 680, dated 22/10/2004	“Për shpalljen e e lagunës Vjosë Nart peisazh i mbrojtur”
11	VKM Nr. 881, datë 14.12.2016	“Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”.
12	Vendim KKT, Nr. 02, datë 14.06.2016	“Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar”
13	Vendim KKT Nr. 01, datë	“Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia

	16.10.2017	Vlorë
14	VKM Nr. 162, datë 02.03.2016	“Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në përdorim të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi turizmin”
15	VKM Nr. 281, datë 13.04.2016	“Për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”
16	VKM Nr. 280, datë 13.04.2016	“Për caktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”
17	VKM Nr. 281, datë 13.04.2016	“Për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”
18	VKM Nr.709, datë 29.10.2014	"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për zhvillimin rural", e ndryshuar
19	VKM Nr. 847, datë 29.11.2007	Strategjia ndërsektoriale e mjedisit
20	VKM Nr. 348, datë 12.05.2016	“Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020”
21	VKM Nr. 1071, datë 23.12.2015	“Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015-2020”
22	VKM Nr. 691 datë 29.07.2015	“Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015 -2020”
23	VKM Nr. 413 datë 19.06.2019	“Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe të planit të veprimit”

2.2 Dokumente planifikimi në fuqi

Disa orjentime dhe kushtëzime që vijnë për zonën nga dokumentet e planifikimit në fuqi bazohen në: Planin e Përgjithshëm Kombëtar Shqipëria 2030, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 881, datë 14.12.2016, VKM Nr. 680, dated 22/10/2004 “Për shpalljen e lagunës Vjosë Nartë Peisazh i Mbrojtur”, nga Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 02, datë 14.06.2016 “Për miratimin e **Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar**” dhe Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë miratuar me vendim të KKT Nr. 01, datë 16.10.2017.

2.2.1 PPKT - Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit

Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit është dokumenti më i lartë i planifikimit në nivel kombëtar, ku paraqitet vizioni dhe prioritetet e zhvillimeve territoriale për të gjithë vendin në 15 vitet e ardhshme. Ky plan përbën bazën për harmonizimin e politikave sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilat kanë impakt në territor apo shoqërohen me efekte në të, strukturon dhe balancon zhvillimet urbane dhe rurale si edhe ofron një klimë të besueshme për investimet afatgjata. Zona e njesive strukturore që përfshihet brenda kufirit të PDZRK Nartë, bën pjesë në “Polin e zhvillimit rajonal Vlorë-Fier-Berat, si një nga rajonet më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në vend konkurues me polin e zhvillimit rajonal Tiranë Durrës” Ky pol përbëhet nga 3 qendra kryesore urbane: Vlorë, Berat, Fier, ndërsa bashkitë: Lushnje Kuçovë, si qendra të specializuara. Ky aglomerim strategjik i qendrave kryesore urbane të këtij rajoni, dëshmon për ekzistencën e një mase kritike të tregu të lirë, prodhimit dhe shkëmbimesh si edhe një qendër gravitacionale e rëndësishme për tërheqjen e popullsisë si fuqi punëtore dhe konsumatore të, kërkesës turistike, ofertën e shërbimeve dhe të prodhimeve bujqësore dhe energjetike.

Në aspektin e zhvillimit ekonomik si dhe falë burimeve të konsiderueshme natyrore, ky pol konkurren denjësisht me motorin më të madh ekonomik të vendit, atë Durrës -Tiranë. Në rajon ndër potencialet kryesore natyrore përmenden fusha e Myzeqesë, rafineritë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës dhe gazit natyror, laguna e Nartës, porti i Vlorës, vija e larmishme bregdetare, kalimi i linjës energjetike TAP etj. Në 15 vitet e ardhshme PPK shihet të realizuara në këtë rajon:

- Përmirësimi i kushteve dhe shtimi i kapacitetit të portit të Vlorës, si nyje portuale kryesore të transportit detar.
- Integrimi dhe funksionimi me kapacitet të plotë sipas modalitetëve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Levan, Nartë dhe Rafineri si stacione mallrash; Vlorë, Fier, Lushnjë dhe Ballsh si stacione qendrore, si dhe rigjallërimi i stacioneve për pasagjerë, Dushk, Gradishtë, Libofshë si edhe Novoselë, Krapës dhe Kasnicë.
- Realizimin e intinerarit Rruga bregdetare peizazhistike, përgjatë qendrave: Divjakë - Pishë Poro - Nartë - Vlorë

Ndër projektet më të rëndësishëm, që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar janë: përmirësimi i kushteve dhe shtimi i kapacitetit akomodues të zonës bregdetare të Vlorës, rehabilitimi i aksit peizazhistik përgjatë bregut etj.

Projektet e përgjithshme të përshkruar në PPK Shqipëria 2030, sipas simeve që ndikojnë apo/edhe lidhen me zonën e PDZR që po studjojmë janë:

Referuar sistemit natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Krijimin dhe ruajtjen e korridoreve të gjelbërta që lidhin zonat e mbrojtura natyrore dhe brigjet lumore.

Referuar sistemit ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi në mënyrë që të mbrohet ekosistemi natyror i zonës.
- Mbulimin me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve për zonat turistike dhe suburbane.




Figura 2, Poli i zhvillimit rajonal Vlore Fier Berat, PPK 2030





Figura 3 Poli i zhvillimit rajonal Vlore Fier Berat, PPK 2030

Në lidhje me infrastrukturën e transportit:

Një nga projektet më të rëndësishme në infrastrukturën e transporti për këtë rajon, mbetet investimi në aeroportin e dytë kombëtar, në jug të vendit, pikërisht në pranë lagunës së Nartës. Në figurën e mëposhtme identifikohet pozicioni strategjik i zonës në lidhje me vendosjen e saj në kryqëzim të korridoreve kombëtare lidhëse të vendit, si edhe potenciali i infrastrukturës portuale dhe energjetike që përmban.



2.2.2 Zona e Peizazhit të Mbrojtur “Vjosë - Nartë”

Njësia Administrative Novoselë dhe Njësia Administrative Qendër Zona e Peisazhit të Mbrojtur (ZPM) Vjosë-Nartë (Kategoria e IVIUCN) është një kompleks ligatinor që shtrihet në Rajonin e Vlorës. Vetë zona mbulon një sipërfaqe prej 19738 hektarësh. Lartësia e kompleksit varion nga 0-246 m mbi nivelin e detit. Pika më e lartë ndodhet midis fshatrave Hoshtimë dhe Llakatund.

Aktualisht territoret në të cilat shtrihen njësitë në studim, bëjnë pjesë në Peizazhin e mbrojtur “Vjose Narte”, të miratuar me VKM Nr. 680, dated 22/10/2004.

Ligji Nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura” përcakton kategorinë “Peizash i mbrojtur” shkallën e V të mbrojtjes me karakteristikat si më poshtë: *“Peizazh i mbrojtur” shpallen territore të mëdha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, sipërfaqet brenda të cilave mund të ketë edhe qendra banimi që zhvillojnë aktivitete, si bujqësia, pemëtaria, pylltaria e peshkimi. “Peizazhi i mbrojtur” menaxhohet për mbrojtjen e vlerave peizazhistike të zonës, diversiteti biologjik, si dhe për çlodhje e argëtim. Kjo kategori përfshin tokë/det/ujë në pronësi publike ose private.”*

Objektivat e ligjit për shpalljen e Peizazhit të Mbrojtur janë të përgjithshme por vlen të përmendim:


- a) fuqizimin e ndërveprimit harmonik të natyrës me kulturën për mbrojtjen e cilësisë të peizazhit, përdorimit tradicional të tokës, praktikave ndërtimore dhe manifestimeve sociale e kulturore, karakteristike të zonës;
- b) mbështetjen e atyre mënyrave të jetesës dhe aktiviteteve ekonomike që janë në harmoni me natyrën dhe ruajtjen e konstitucionit shpirtëror dhe kulturor të popullsisë lokale;
- c) eliminimin, ku është e domosdoshme, dhe parandalimin e përdorimit të tokës dhe kryerjen e aktiviteteve që janë të papërshtatshme në përmasa dhe/ose përmbajtje;
- ç) krijimin e mundësive për kënaqësi të publikut përmes çlodhjes dhe turizmit, në përputhje me karakterin dhe përmasat e karakteristikave thelbësore të zonës;
- d) nxitjen e aktiviteteve shkencore dhe edukative, të cilat ndihmojnë në zhvillimin dhe mirëqenien për një kohë të gjatë të popullsisë lokale dhe në sigurimin e mbështetjes së gjerë publike për mbrojtjen e mjedisit të zonave të mbrojtura të tilla;
- dh) sjelljen e përfitimeve ekonomike dhe dhënien e kontributit në rritjen e mirëqenies së popullsisë lokale përmes shfrytëzimit të produkteve natyrore, si pyje dhe prodhimi i peshkut, dhe shërbimeve, si uji i pastër ose të ardhura që vijnë nga format e përshtatshme të turizmit.

Pika 4, neni 20 i këtij ligji përcakton se:


Veprimtaritë, që ndryshojnë përdorimin e territorit si ndërtimet, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane, si dhe veprimtari të ngjashme me këto, lejohen të ushtrohen vetëm nëse subjekti që kërkon të kryejë veprimtarinë është pajisur me leje nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Duhet theksuar se plani i menaxhimit daton i miratuar që në vitin 2004, pas 16 vjetëve mund të themi se nuk i përgjigjet dot dinamikës së zhvillimeve të fundit në territor dhe ndryshimeve të


reja si ligjore dhe territoriale ashtu edhe ekonomike strategjike. Megjithatë vlen të përmendin dhe të mbahen në konsideratë disa konstatime të rëndësishme nga ky studim për sa i përket biodiversitetit dhe vlerave që mbart kjo zonë.



Harta 2. Zonimi i brendshëm i peizazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë



Harta 3. Habitatet e ndryshme të Peizazhit të mbrojtur Vjosë-Nartë



Harta 4 Territori i PDZRK-së në raport me Zonën e Mbrojtur

2.2.3. Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar

Një dokument tjetër sektorial i cili jep kufizime dhe drejtime zhvillimi për këtë zonë është Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 02, datë 14.06.2016 “Për miratimin e **Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar**”.

Plani e përcakton qytetin e Vlorës si Qendër Parësore, e cila bën pjesë në polin e zhvillimit rajonal Gjirokastër-Sarandë, porta jugore e rivierës shqiptare. Më specifikisht në dokumentin e planit të zhvillimit të këtij plani, thuhet:

Ky pol zhvillimi rajonal perfshin fashen territoriale me fokus drejt zhvillimit të shërbimeve të turizmit detar, kulturor, mirëqënies fizike dhe ekonomisë blu në hapësirën territoriale nga laguna e Nartës (Vlorë) në veri deri në kepin e Stillos (Konispol) në jug.

Plani përcakton zhvillimin ekonomik të orientuar drejt turizmit bregdetar dhe turizmit kulturor, duke përfshirë turizmin e detit dhe rërës, turizmin nënujor, turizmin e krauzierave, turizmin e jahteve, turizmin historik/ arkeologjik, fetar etj., bazuar në resurset kryesore të zonës.

Ky plan e përcakton zonën e Rëndësisë Kombëtare Vjosë-Nartë pjesë të fashës së tretë (Grykëderdhja e Vjosës (N15)) me sektorin e turizmit Natyror dhe Aventure me tipologji Ekoturizëm, Hipizëm, Ecje në Natyrë. Target grupi i synuar janë ambientalistët, individualët dhe turistët ditor.

Aktivitetet do të jenë të orientuara kryesisht në aktivitete që kombinojnë turizmin “det-diel” me atë natyror dhe agrikulturor, duke u bazuar në praninë e burimeve natyrore.

Zona ka potencial të jahtzakonshëm për t’u zhvilluar për shkak të traditës së konsoliduar të të jetuarit duke punuar e prodhuar prej tokës, si edhe mirëqendjes, së vërtetuar tashmë, që krijohet edhe duke kryer aktivitete bujqësor.

Gjithashtu zona do të shërbejë si ndërmjetëse për lidhjen e turizmit bregdetar dhe përfitimin e tij nga vlerat e turizmit rural/agrikulturor. Produktet bujqësore vendase, të cilat prodhohen e përpunohen në lokalitetet në afërsi të bregdetit, do të shërbejnë për turistët e akomoduar, jo vetëm në bregdet. Lokalitetet do të shërbejnë si pole ku do të zhvillohen klasterat me karakter bujqësor, sikurse do të shërbejnë edhe si njësi shërbimi e akomodimi.

Turizmi aktiv dhe i aventurës, kërkon zhvillimin e aktiviteteve sportive tokësore dhe detare të tilla si: hipizmi, gjuetia, ecja në natyrë, lundrimi me vela, me kajak, zhytje etj. Plani sheh të lidhur ngushtë aktivitetet e aventurës me ato kulturore në bazë vjetore, si festat tradicionale, festivalet, panairët etj., me qëllim forcimin e identitetit të kësaj zone me potenciale turistike.

2.2.4 Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë

PPV Vlorë propozon zhvillime të kategorisë N-Natyre dhe U-Ujore në njësitë NO.N.65, NO.N.78, NO.N.176, NO.N.65 dhe NO.U.87, NO.U.100, NO.U.101 sipas parametrave të paraqitur në pasaportat e këtyre njësive në rregullore. PPV ka përcaktuar në vija të përgjithshme rrjetin infrastrukturor në këtë zonë




Figura 5 Përcaktimet e PINS Bregdeti për Fashën 3



Figura 6 Ekstrakt nga harta e përdorimit të propozuar të tokës, PPV Vlorë





Figura 7 Infrastruktura e Transportit e propozuar, PPV Vlorë



3. Permbledhje e Analizes dhe Strategjise Territoriale

Permbledhja e Analizës territoriale do të bazohet në dokumentet e mësipërme të planifikimit territorial dhe në informacionin e perditesuara nga institucionet përgjegjëse për hartimin e kësaj PDZRK, dhe do të strukturohet në tamtikat baze ; pronesi, aksesit dhe infrastruktura, zhvillimet ekzistuese, gjendja mjedisore, bujqesia.

3.1. Analiza e pronësisë

Zona e Poros është pjesë e Myzeqesë së Vogël ose e njohur edhe si Myzeqeja e Vlorës e cila ndodhet në jug dhe jug-perëndim të Rajonit Jugor, pikërisht në Ultësirën Bregdetare në jug të grykëderdhjes së lumit Vjosa. Zona ka një topografi të ndryshueshme, e mbuluar nga bimësi të bollshme me aksesin e vet në bregdeti. Është e arritshme në afërsisht 1-1,5 orë nga kryeqyteti, Tirana dhe rreth 30 minuta nga Vlora dhe Fieri. Bregu i detit dhe lagunat e vogla janë ndër pikat më të forta të vendndodhjes së bashku me pamjet mahnitëse mbi vijën bregdetare të Adriatikut dhe ishullin e Sazanit. Vendndodhja strategjike, forma e sitit dhe karakteristikat e zonës sigurojnë mundësinë e zhvillimit të një vendpushimi unik dhe privat. Zona e Poros mbetet një nga vendet më pak të zhvilluara, kështu që bregdeti i Poros është i mbushur me rërë të virgjër të bardhë dhe bimësi karakteristike të asaj zone. Sidoqoftë, Plani i Përgjithshëm Lokal i Bashkisë Vlorë për zhvillimin e territorit përfshin edhe zonën e Poros. Në tërësi, territori subjekt i PDZRK-së ka një sipërfaqe prej 2,083.22 ha, të shpërndarë në 7 njësi strukturore.

Sipërfaqja prek disa zona kadastrale në ZVRPP Vlorë, si më poshtë:

1. Zona Kadastrale 1007 (Akerni) – 391.2 ha

- Në këtë zonë kadastrale pjesa e kërkuar prek disa pasuri të llojit kanal, rrugë.

2. Zona Kadastrale 1460 (Delisuf) - 231.5 ha

- Sipërfaqe në pronësi Shtet = 72.8 ha
- Sipërfaqe me pronarë = 158.6 ha

3. Zona Kadastrale 1462 (Dellenje) = 219.5 ha

- Sipërfaqe në pronësi Shtet = 177.8 ha
- Sipërfaqe me pronarë = 41.6 ha

4. Zona Kadastrale 3028 (Poro) = 9.9 Ha

- Sipërfaqe në pronësi Shtet = 8.1 Ha
- Sipërfaqe me pronarë = 1.7 ha

5. Zona Kadastrale 3951 (Zvernec) = 206.2 ha

- Sipërfaqe në pronësi Shtet = (47 ha)
- Sipërfaqe me pronarë = (159.2 ha)



Harta 5 pretendimet e pronësive, Burimi: ASHK, 2019



Harta 6 e zonave kadastrale. Burimi; ASIG, 03/2020

Sipas informacionit të mësipërm, një pjesë e mirë e territorit në studim është privat apo në proces njohje. Territori i Fashatrave tradicional gjithashtu karakterizohet nga përdorime private, ndërkohë që zonat e zëna nga aktivitete të tjera si kriporja janë në menaxhim privat.

3.2. 3.2 Aksesi dhe infrastruktura lidhese

Lidhur me aksesin dhe infrastrukturën rrugore, territori në gjendjen aktuale paraqitet deri diku i izoluar. Kjo së pari për shkak statusit të meparsheh dhe së dyti për tipologjinë e tokave perberese të terrenit. Megjithatë zhvillimet e fundit infrastrukturore, përmendim këtu realizimin e Autostradës Kombëtare “100 Vjetori i Pavarësisë” vetëm 10km larg zonës në studim, ka ndryshuar panoramën e aksesit në këtë territor. Një zhvillim tjetër me rëndësi në aksesin e zonës është miratimi i nismës për realizimin e një prej projekteve me të rëndësishme të viteve të fundit, aeroporti i dytë ndërkombëtar i vendit, vetëm 3-5km larg territorit në studim. Porti i Vlores ndërkohe ndodhet vetëm 20km larg dhe ndërmjet këtyre dy pikave zhvillojnë aktivitetin e tyre porti i vogël i peshkimit.

Zona aksesohet për më pak se dy ore nga Tirana dhe deri në 15 min nga Vlora. Ndërkohë, qendra më e afërt e banuar është Novosela deri 12 min larg me makinë. Me investimet në infrastrukturë dhe rritjen e interesit turistik për Shqipërinë nga vendet e Europës dhe më gjerë, zona mbetet një nga pikat më atraktive për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme në këtë drejtim. Është e kuptueshme se me shtimin e strukturave pritëse në zonën do të lindë nevoja për infrastrukturë sekondare të shtuar si edhe përmirësim të rrugëve të aksesit ekzistuese.




Figura 9 Diagrama Studimi të Sistemit Infrastruktural

Sistemi rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit të vendit dhe kryesisht në mbështetjen e zhvillimit të turizmit. Në këtë moment nuk ka rrugë të vazhdueshme nga bregu, lugina dhe më pas në zonën Pishë-Poros. Kjo e bën përvojën rrugore të fragmentuar.

Rrugët e Poro janë sekondare ose terciare, që do të thotë se janë të ngushta. Ndër pengesat e sistemit ekzistues rrugor është fakti që rrugët që çojnë në bregdet janë të degraduara dhe në gjendje të dobët, në sezonin me shi ato bëhen të pakalueshme, gjithashtu mungojnë trotualet dhe gjelbërimi në rrugë. Disa nga këto rrugë janë propozuar për rehabilitim.

Zona e Poros është përfshirë në një nga projektet më të rëndësishme për aksesueshmërinë e zonës së Vlorës, siç është "Rruga Bregdetare", e cila përfshin Divjakë-Poro-Narta-Vlorë-Dhërmi (Një Projekt me përparësi të Ministrisë së Transportit 2014)




Figura 10 Infrastruktura ekzistuese, foto





Figura 11 Diagrama të shpërndarjes dhe lidhjes së qendrave lokale të zonës në studim



Harta 7. Harta e infrastrukturës lidhëse, PPV Vlorë

Në destinacion shkohet duke ndjekur rrugën nacionale Vlorë-Fier (Vlorë-Kriporja-bregdeti i Nartës-Hidrovori), ose Vlorë-Pylli i sodës-fshati Zvërnec. Rrjeti rrugor në rrethin e Vlorës ka një zgjerim prej 200 km. Ekzistenca e tij mundëson zhvillimin e turizmit, ndonëse duhet theksuar se cilësia e rrjetit rrugor nuk është shumë e mirë. Parashikohet që në këtë rrjet mund të kalojnë afro 4 000 makina në ditë gjatë verës dhe afro 5 000 makina gjatë fundjavës verore. Transporti publik midis Vlorës dhe Nartës kryhet me anë të autobuzave.

Furnizimi me ujë

Njësia Administrative e Novoselës si dhe një pjesë e Njesisë Administrative Qendër (Trevllazër, Panaja, Oshëtima) furnizohen nga stacioni i pompimit të Novoselës. Uji merret nga 6 puse secili me një kapacitet prej 25 l/sek. Komuna Qendër furnizohet nga burimi i "Ujit të Ftohtë" nëpërmjet stacionit Nr. 4 me një kapacitet prej 5 l/sek. Uji është i siguar për 24 orë. Megjithë rezervat ujore të mëdha, përsëri furnizimi me ujë mbetet problematik për Novoselën. Në vend të

kuotës së përcaktuar prej 150 l/person, furnizimi i sotëm është vetëm 90 l/person. Mangësia e furnizimit me ujë lidhet me amortizimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit, keqpërdorimin, mungesës së energjisë elektrike etj. Planet e rehabilitimit të rrjetit ujqor janë tashmë të përfunduara. Këto plane i sigurojnë Novoselës ujë të rrjedhshëm në 24 orë.

Përsa i përket ujitjes së tokave bujqësore, kjo bazohet në ujërat e lumit Vjosë si dhe në rezervuarët e Panajasë. Infrastruktura e ujitjes përbëhet nga një stacion ujqor në Mifol me një kapacitet prej 4 000 l/sek. Destinacioni final i sistemit të ujitjes është toka bujqësore e Akërnisë dhe rezervuarët e peshkimit në Gorricë. Sipërfaqja e tokës së ujqitur sot kap 1 100 ha. Toka bujqësore e Qëndrës furnizohet nga rezervuari artificial i Panajasë me një kapacitet prej 1.4 million m³ ujë për një sipërfaqe prej 300 ha.

3.3. Analiza e zhvillimeve ekzistuese (ndërtesat, lartësitë e kateve, intensiteti, ksh, cilësia e ndërtimeve).

Aktualisht, në territorin e njërive strukturore në studim nuk ka struktura ekzistuese, Harta 6 Gjendja Kadastrale e ilustruar më lart dhe Figura 9 Pamje ajrore e zonës në studim. Vendbanimet më të afërta janë ato të Zhukë Grykëshqipe, Poro dhe Akërnia.



Figura 12 Pamje ajrore e zones në studim

Zona në studim nuk i prek këto vendbanime por pritet të sjellë një impakt pozitiv në banorët e këtyre fshatrave sidomos në punësim dhe rritjen e aktivitetit tregëtar të prodimeve bujqësore të tyre.



Figura 13 Pamje nga zona, Objektet ekzistuese, janë të përqendruar në zonat e fshatrave tradicionale

3.4. Profili demografik

Fshatrat dhe Popullsia (shpërndarja e saj qytet dhe fshat)

Zona e Pejsazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë banohet nga një popullsi prej afro 24 000 banorësh të shpërndarë në 18 qendra urbane. Numri i familjeve është rreth 5 440, me një mesatare prej 4-5 personash për familje. Numri mesatar i banorëve në qendrat urbane varion nga 573 banorë në fshatin Skrofotinë deri në 3693 banorë në fshatin Nartë.

Dendësia e popullsisë në Novoselë është 108 banorë/km² ndërsa për vetë Njësinë Administrative, densiteti është vetëm 35,5 banorë/km². Dendësia në Njësinë Administrative Qendër është 189 banorë/km², ndërsa në komunë nuk ka më shumë se 49 banorë/km². Gjatë viteve 90's numri mesatar i lindjeve për Njësinë Administrative Qendër ishte 17.4/1000 banorë ndërsa në Novoselë 14.2 /1000 banorë. Shkalla e rritjes së popullsisë gjatë viteve 1989-1999 është afro 13%. Rritja mesatare vjetore është 360 persona në vit, një nga shkallët më të larta të rritjes në Shqipëri. Tendencat e ardhshme parashikojnë një rritje të mëtejshme të numrit të familjeve dhe një rënie të numrit të anëtarëve për familje.

3.5. Ekonomia lokale

Ekonomia lokale është kryesisht e përqendruar në ekonominë bujqësore, ndërkohë që turizmi bregdetar dhe ai natyror janë pothuaj të pazhvilluar për shkak të aksesit të dobët në zonë, mungesës së mirëmbajtjes të territorit si edhe degradimit të vazhdueshëm të habitatit natyror dhe të bregdetit për shkak të erozionit dhe mungesës së ndërhyrjeve të mirëplanifikuara për ruajtjen e tyre. Më poshtë përshkruhen aktivitetet kryesore ekonomike në zonë, referuar burimeve nga PPV, Plani i Menaxhimit për Zonën e Mbrojtur si edhe vizitat në territor.

Bujqësia

Për Njësinë Administrative të Novoselës, pjesa më e madhe e tokave i takon kategorive VI, VII dhe III. Ndërsa në Njësinë Administrative Qendër dominojnë kategoritë V, VIII dhe IV. Sipas specialistëve përkatës, cilësia më e mirë e tokës i takon përgjithësisht kategorive 1-3. Sipas statistikave bujqësore, sipërfaqja më e madhe e tokës përdoret për prodhimin e foragjerëve, grurit

dhe perimeve të ndryshme. Po këto kultura zënë dhe peshën kryesore në prodhim. Gjatë viteve të fundit, sipërfaqja e tokës bujqësore e përdorur për drithëra është reduktuar në favor të perimeve. Një pjesë e tokës bujqësore është transformuar në sera për prodhimin e domates dhe të kastravecit. Megjithë rëndësinë e tij të vogël, aktiviteti bujqësor vuan nga mungesa e një tregu bujqësor të organizuar, infrastrukturës së transportit, zhvillimi i dobët i agro-industrisë, mungesa e kredimeve bankare për fermerët, shërbimet e dobëta agronomike etj.

Prodhimi i frutave

Pemtaria, nuk është shumë e zhvilluar megjithë nismat e kohëve të fundit veçanërisht në Bishan dhe Nartë kanë sjellë rritje të peshës së saj në ekonominë lokale.

Megjithatë, prodhimi i frutave është një aktivitet i rëndësishëm ekonomik dhe një burim i vlefshëm të ardhurash. Ai ka potencial për shkak të kushteve të mira të tokës, gjeomorfologjisë, klimës si dhe traditës. Në Njësinë Administrative Qendër prodhimi i frutave zë 21% të prodhimit bujqësor ndërsa në Novoselë vetëm 8.4% të tij. Njësia Administrative Qendër ka gjithashtu 118 000 rrënjë ullinj që japin 60% të prodhimit total të ullinjve në rrethin të Vlorës. Gjatë viteve të fundit, ka një rritje të interesit për vreshtarinë e cila përdoret për prodhimin e verës dhe të rakisë. Kjo sipërfaqe rritet për çdo vit me 8 ha në Njësinë Administrative Qendër dhe me 5-6 ha në Novoselë.

Blegtoria

Blegtoria është një aktivitet ekonomik që sjell mjaft të ardhura. Në Njësinë Administrative Qendër, aktiviteti blegtoral jep 34% të të ardhurave ndërsa në Novoselë ku aktivitet është akoma më i rëndësishëm me 57% të të ardhurave. Pjesa më e madhe e blegtorisë përbëhet nga dele, lopë dhe dhi. Gjithashtu i lartë është dhe numri i pulave. Çdo famlje ka mesatarisht një lopë, dy dele dhe disa pula për nevojat familjare. Disa prej fermereve kanë nisur mbarështimin e fermave të vogla prodhuese për mish, qumësht, vezë dhe mjaltë. Destinacioni final i prodhimeve blegtorale është tregu vendas si dhe përdorimi vetjak. Në total zona ka 4 100 gjedhë, 25 200 dele etj. Çdo përmirësim në cilësinë e kullotës dhe furnizimin me ujë për bagëtinë do të rriste sigurisht një aktivitet të tillë si dhe rëndësinë e saj ekonomike. Ashtu si dhe prodhimi bujqësor, edhe prodhimi blegtoral vuan nga mungesa e një tregu blegtoral të organizuar, mungesa e infrastrukturës së transportit, zhvillimi i dobët i agro-industrisë, mungesa e kredimeve bankare, shërbimet e dobëta veterinare etj.

Agro-industria

Agro-industria nuk është shumë e zhvilluar megjithë larminë dhe begatinë e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Tashmë është rritur shumë vëmendja për prodhimet vendase por mungesa e infrastrukturës dhe logistikës bujqësore mbetet sërish një pengesë e rëndësishme. Në zonë janë ngritur disa fabrika përpunuese të produkteve të ndryshëm si djathit, vajit të ullirit, bimëve mjeksore, pijeve alkoolike dhe freskuese, sallamrave, lëkurës, leshit etj.

Në Novoselë ka gjithashtu një fabrikë të përpunimit të bretkosave dhe të tregtimit të tyre. Kjo degë e industrisë ushqimore funksionon që prej 30 vjetësh. Gjatë 10 viteve të fundit, sasia mesatare e prodhimit të mbledhur është afro 2 700 kv/vit. Ndërmarrja punëson çdo vit afro 60 punëtorë sezonalë. Modernizimi dhe investimet e mëtejshme në agro-industri besohet se do ta kthejnë atë në një mbështetëse të fuqishme të industrisë turistike në zonë dhe më gjerë.

Turizmi

Kjo zonë gërsheton një larmi kushtesh të përshtatshme për zhvillimin e turizmit si klimë të shëndetshme dhe kushte sociale e ekonomike të favorshme. Megjithë rritjen e kërkesës për turizëm, kjo degë nuk është ende shumë e zhvilluar për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe planeve të përshtatshme urbane. Përveç kësaj duket se qeveria shqiptare nuk ka ende një strategji të qartë për zhvillimin e turizmit në zonën e Vlorës. Vendimet e fundit të qeverisë si kërkimi i naftës, krijimi i parkut industrial dhe energjistik e dëmtojnë perspektivën turistike të zonës. Megjithë mungesat e sipërpërmendura, në Njësinë Administrative të Novoselës vazhdon të praktikohet turizmi ditor. Gjatë fundjavave verore, numri i turistëve ditor shkon deri në 250-270 persona. Piku turistik arrihet në periudhën 15 Korrik - 15 Gusht. Turizmi familjar është ende në hapat e tij të parë. Afro 150 familje vijnë çdo vit në zonë për turizëm balnear.

Peshkimi

Gjatë periudhës 1975-1990 kapjet vjetore të peshkut ishin afro 55 kg/ha (d.m.th. 1 590 kv/vit) me një maksimum prej 70 kg/ha (2 023 kv/vit) në vitet 1980-87. Afro 30% e prodhimit vjetor përbëhej nga gaforret (*Carcinus aestuarii*). Sipas të dhënave më të fundit, numri i peshkatave dhe kapjet kanë shënuar rënie përkatësisht. Numri i peshkatave të ligjshëm ka rënë në 50 vetë ndërsa zëniet në vitin 2003 janë 46 kg/ha ose 1 340 kv/vit.

Llojet kryesore të peshkut janë qefulli (katër lloje të ndryshme), ngjala, levreku, kocja dhe aterina. Struktura e peshkut dominohet nga qefulli, peshk i cili ka dhe një vlerë të ulët në treg. Llojet më vlera të larta si levreku dhe kocja përbëjnë vetëm 25 % të zënieve. Këto sasi janë 2-4 herë më të ulëta se në lagunat e tjera bregdetare të Shqipërisë. Sot peshkimi punëson 50-100 persona. Zonat e peshkimi përfshijnë lagunën e Nartës, Limopuan, Derdhjen e vjetër të lumit Vjosë, lagunën e Kallënges, lumin Vjosa dhe brezin litoral. Peshku shitet kryesisht në restorantet e Vlorës, Fierit etj. Një pjesë e vogël shkon dhe për konsum familjar. Në përgjithësi zëniet e peshkut konsiderohen si të pakta për shkak të disa faktorëve të nxitur nga njeriu apo nga natyra. Siç është thënë dhe më parë, laguna e Nartës vuan nga eutrofikimi, i cili vjen nga mungesa e komunikimit me detin, marrjen ekseseve të ujit nga kriporja, mungesën e ujit të ëmbël, derdhjen e ujërave të zeza, futjen e ndotësve organikë industrialë etj. Përveç kësaj peshkimi i jashtëligjshëm është mjaft i zakonshëm. Syzja e rretës është shpeshherë shumë më e vogël se normat e lejuara duke çuar kështu në kapjen e peshqve tepër të vegjël (madhësi dhe moshë). Anije të mëdha peshkimi gjuajnë në cektina detare dhe shkatërrojnë kështu rezervat peshkore që pritet të hyjnë në ujërat e lagunës.

Prodhimi i kripës

Kriporet mbulojnë sot një sipërfaqe prej 1 472 ha. Prodhimi i kripës nisi në vitin 1958. Në vitet e para, kriporet prodhonin rreth 25-30,000 ton/vit (Fig. 7) dhe punësonin afro 250 vetë prej fshatrave të zonës dhe qytetit të Vlorës. Prodhimi u rrit në vitin 1970 me 70 000 ton dhe punësonte deri në 800 vetë. Në vitin 1975, kriporet nisën nxjerrjen në treg të kripës së jodizuar me një kapacitet prej 5 000 ton/vit. Prodhimi arriti maksimumin e vet në vitet 1975-1985 me një total prej 140 000 ton kripë. Në atë kohë, kriporet punësonin afro 1250 vetë.

Kontrolli i erozionit

Megjithëse në një shkallë të kufizuar, erozioni është një fenomen natyror në zonën e studimit, duke patur parasysh karakteristikat gjeologjike, fizike dhe kushtet klimatike të zonës. Është e vërejtur kryesisht në vargun kodrinor i cili përbën kufirin lindor të zonës së projektit. Por erozioni shfaqet dhe si një fenomen i kohëve të fundit i nxitur nga prerjet pa kriter, mbikullotja

dhe zjarret. Si i tillë është sigurisht një problem për tu marrë në konsideratë nga plani i menaxhimit. Rehabilitimi i habitateve të degaduara do ta parandalonte kthimin e erozionit në një fenomen të zakonshëm.

Pylltaria

Zonat pyjore përdoren për kullotje, dru zjarri dhe mbledhje tagjie. Shfrytëzimi i drurit nuk përbën ndonjë problem akut për momentin. Disa nga aktivitetet e përmendura më lart kanë nevojë për kontroll në mënyrë që të parandalohet degradimi i mëtejshëm i pyjeve dhe shkurretave.

Fermat bujqësore

Është e sigurt që aktiviteti ekonomik kyesor në zonën e projektit është bazuar në sipërfaqjet e mëdha të tokave bujqësore dhe veçanërisht në ullishtet. Një pjesë e madhe e tokave bujqësore sot është braktisur për shkak të mungesës së një rrjeti kullues dhe ujitës. Në rast rehabilitimi të një rrjeti të tillë, bujqësia mund të jetë përsëri aktiviteti ekonomik më premtues i zonës.

Bimët mjeksore

Në peizazhin Vjosë-Nartë janë evidentuar 114 bimë aromatike mjekësore ku përmendim *Alkanna tinctoria* Tausch., *Allium sativum* L., *Anethum graveolens* L., *Bellis perennis* L., *Brassica nigra* (L.) Koch., *Capsicum annum* L., *Cichorium intybus* L., *Daucus carota* L., *Dianthus caryophyllus* L., *Juniperus oxycedrus* L., *Matricaria camomila* L., *Myrtus communis* L., *Ocimum basilicum* L., *Papaver rhoeas* L., *Phragmites communis* Trin., *Portulaca oleracea* L., *Rosa canina* L., *Urtica dioica* L. etj. Megjithatë, prania e tyre listohet si potencial, por ende jo me kontribut domethënës në ekonominë lokale.

Aktivitete pushuese dhe turistike

Zona e projektit ofron potenciale të larta për aktivitete të turizmit dhe të kohës së lirë. Siç është përmendur dhe më lart aktivitetet e turizmit mund të bazohen në një infrastrukturë të zhvilluar mirë si dhe në shërbimet e akomodimit. Zona është e famshme për pasuritë e saj natyrore dhe kulturore të cilat mund të mbështesin aktivitete eko-turistike të shumta të tilla si shëtitje (Kallënga dhe Rezervati i Menaxhuar i Pishë-Poros), vrojtime shpendësh në lagunën e Nartës dhe në Kriporet, turizëm kulturor në zonat historike të Zvërnecit dhe të Treportit. Fatkeqësisht deri tani është bërë shumë pak për zhvillimin e turizmit miqësor me mjedisin. Disa nga zonat e përdorura sot për aktivitetet pushuese nuk janë të kontrolluara dhe kanë sjellë ndotje dhe shqetësim të botës së egër.

Rekomandime

Panorama e mësipërme qartëson hendekun e madh midis potencialit që ofron zona në studim, kontributin e limituar të saj në ekonominë lokale dhe akoma më pak në atë kombëtare si edhe degradimin e vazhdueshëm të gjendjes natyrore të saj për shkak të mungesës së mirëmbajtjes duke impaktuar negativisht në këtë mënyrë të gjithë gjendjen e habitatit. Propozimet e PDZRK për investime strategjike dhe inteligjente, suksesi i të cilave bëhet i garantuar vetëm nëpërmjet investimit në mirëmbajtje dhe përmirësim të habitatit dhe gjendjes natyrore të zonës, janë një garanci për realizimin e një modeli suksesi në këtë drejtim, ku natyra ekonomia dhe shoqëria mund të zhvillohen bashkërisht, në mbështetje të njëra tjetrës, në materializimin e modelit real të zhvillimit të qëndrueshm.

3.6. Analiza e sizmike

Nën dritën e ngjarjeve të fundit sizmike që kaloi vendi yne ne datat 21 Shtator dhe 26 Nentor 2019, por jo vetem, ka rendesi adresimi i kësaj analize në një nivel më të detajuar në fushën e planifikimit, e tillë që të adresojë direkt kushtet dhe masat konkrete të nevojshme që duhen parashikuar për shmangien pa dëme të kësaj dukurie natyrore. Instrumenti i planeve të detajuara qofshin këto në nivel kombëtar apo vendor, janë një nga instrumentet me të rëndësishëm të planifikimit që synojnë të zbatojnë në praktikë të gjitha propozimet territoriale të shprehura nga instrumentat e niveleve me të larta të planifikimit qofshin keto në forme strategjie , politikash qëllimet dhe iobjektivat, projektet strategjike, masat dhe deduktimet nga analizat e shumefishta historike, sociale ekonomike, të infrastruktures etj. Të gjithë instrumentat e planifikimit, të niveleve të ndryshme hierarkike duhet të jenë në harmoni dhe koherencë të plote me njëri tjetrin për sa i përket vizionit, qëllimit dhe objektivave që përcjellin për zhvillimin e një territori. Në nivelin e Planit të Detajuar bëhet zbatimi praktik i tyre nepermjet dezajnit urban por edhe kushteve të zhvillimit. Për zonën në studim ne do ti referohemi analizave të riskut sizmik që ka paraqitur Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vlorë.

Referuar dokumentit të Masterplanit për aeroportin e Vlorës, është bërë një vlerësim i përgjithshëm i zonës së Vlorës, duke marrë në konsideratë kriteret kryesore dhe nën-kriteret lidhur me aspektet gjeologjike:

- Zona e studiuar në fushën e Novoseles , përfaqëson një terren të sheshtë të depozitimeve të Kuaternarit të Konsoliduar
- Për këtë zonë të dyja shtresat kryesore (3 dhe 4) kanë qëndrueshmëri si në vertikalisht ashtu dhe në shtrirje. Nuk kanë zhvillim thjerrzor. Për këtë, në mbështetje të klasifikimit të lartparaqitur
- Diametri predominues është i fraksionit pluhuror.
- Zona e studiuar në (Novosele Vlore) paraqet formacione ku mungon krejtësisht frakturimi dhe volumet bosh. Shtresat e takuara nga punimet e kryera kanë shtresëzim pothuajse horizontal.
- Zona e Novoseles (Vlore) është pjesë e Ultesires Praneadruatike, më saktë është ekstremi jugperendimor i saj. Në këtë zonë nuk janë vërejtur thyerje apo shkeputje tektonike. Shtresat që formojnë zonën pothuajse janë horizontale. Nga pikepamja sizmike kjo zonë hyn në zonat me sensibilitet të konsiderueshëm sizmik. Intensiteti maksimal në zonë është llogaritur rreth 8 balle.

Përsa i përket kushteve tektonike

- Përsa i përket qëndrueshmërisë së sipërfaqes. Zona e Novoseles (Vlore) nuk ka asnjë problem destabilizimi.
- Përsa i përket kushteve hidrogeologjike. Zona e Novoseles (Vlore) është zonë që ndikohen drejt për drejt nga ujrat sipërfaqesore dhe permbajtja e ujit në formacionet e tyre është mbi 30% Megjithatë, me avancimin e zbatimit të projekteve të parashikuara në këtë zonë, studime më të detajuara duhet të kryhen si mikrosizmit dhe prova/shpime të qëndrueshmërisë gjeologjike.

Analiza gjeologjiko-inxhinierike dhe gjeologjike, gjithashtu kanë rëndësi të vecante për sa i përket treguesve të qendrueshmerise së terrenit dhe kushteve teknike shtese, që duhet të merren parasysh gjatë zhvillimit të kësaj zone. Si mund të vihen re edhe nga haratat tematike të kësaj analize, njesite perberese të PDZRK perbehen nga shtresa të depozitimeve kenetore. Indekse Qh, Holocen. Depozitime aluviale: alevrite, rëra, zhavore.



Figura 14 Harta e Gjeorezikeve. Burimi, SHGJSH




Figura 15 Rrezikut Gjeologjik , Burimi: SHGJSH




Figura 16 Harta e pershtatshmerise se ndertimit te trojeve, Vlore, Burimi SHGJSH



Figura 17 Harta e detajuar gjeologjike, Novosele, Burimi SHGJSH

Rekomandime

Mbështetur në informacionin e mësipërm, bëhet e qartë që përpara çdo investimi që do të materializojë zbatimin e PDZRK, studimi mikrosizmik, provat e qëndrueshmërisë së dherave si edhe projekti konstruktiv duhet të jenë në përputhje me shkallën e rrezikut sizmik që paraqet zona. Nga kjo pikëpamje, studimi parashikon struktura me lartësi të ulët dhe me tregues zhvillimi minimalë nga 0.5-1.2 intensiteti dhe koeficient shfrytëzimi të territorit nga 16-25%. Këto parametra zhvillimi janë elementët e sigurisë që mund të ofrojë ky studim në përballjen me sukses të rriskut sizmik.

4. Gjendja mjedisore

4.1. Klima, erërat, diellëzimi dhe rreshjet

Zona në studim ndodhet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe si e tillë ajo karakterizohet nga fusha klimatike Qëndrore Mesdhetare. Dimri është përgjithësisht i butë, me rreshje të shumta ndërsa vera e nxehtë dhe e thatë. Rreshjet bien kryesisht në formën e shiut.

Lagështia e ajrit është e lidhur me temperaturën. Mesatarja mujore e lagështisë ndryshon nga 62 - 69 %, ndërsa mesatarja vjetore është 66%. *Era* kryesore është briza detare, tepër e dukshme sidomos gjatë verës. Stina e dimrit dominohet përgjithësisht nga era e lindjes me një shpejtësi mesatare prej 3.5 m/s. Drejtimi kryesor i erës është ai lindor (24.4 %) i ndjekur nga drejtimi verilindor. Vera dominohet nga briza detare me drejtim perëndimor. Drejtimi kryesor është ai veriperëndimor (17.6 %) dhe perëndimor (9.4 %). Shpejtësia mesatare e erës është përkatësisht 4.4 m/s dhe 5.2 m/s.

Rreshjet e borës janë tepër të pakta dhe me kohëzgjatje shumë të shkurtër. *Rrezatimi diellor* si një nga faktorët klimatike kryesorë është mjaft uniform në të gjithë zonën. Vlera vjetore mesatare e rrezatimit diellor është 1540 këh/m². Vlera më e lartë regjistrohet në Korrik (216.5 këh/m²) ndërsa ajo më e ulët në Dhjetor (52.1 këh/m²). *Temperatura mesatare* vjetore varion nga 15.4 °C në Llakatund deri në 16.3 °C në Vlorë. Temperatura maksimale vjetore kapet në Korrik/Gusht me 30.0 °C ndërsa minimalja në Janar me 4.8 °C. Për shkak të thellësisë së kufizuar, regjimi termik i ujërave të lagunës është i ngjashëm me temperaturën e ajrit. Uji i detit që hyn në lagunë ka një ndikim të madh në regjimin termik, veçanërisht pranë kanaleve të vetë komunikimit. Temperaturat më të ulëta në lagunë regjistrohen në periudhën Dhjetor-Janar ndërsa më të lartat në Korrik-Gusht.

Temperatura mesatare vjetore është 14.9°C. Rreshjet mesatare në zonë kapin shifrën e 892 mm në vit. 80% e rreshjeve bien gjatë periudhës së lagësht të vitit (Tetor-Maj) dhe vetëm 20% gjatë periudhës së thatë. Vlera mesatare vjetore e avullimit është 1173 mm (56% e saj gjatë periudhës së nxehtë të vitit). Kjo vlerë tregon se avullimi është më i lartë sesa rreshjet, fakt ky që tregon qartë se ekosistemi ka nevojë për prurje ujore




Figura 18. Trëndafili i erërave për Vlorën

Siç mund të shihet, shpejtësitë më të mëdha të erës vihen re në drejtimet JP, J, dhe P. Për sa i përket shpeshtësive më të mëdha ato kane drejtimin JP.

4.2. Gjeomorfologjia

Në zonën e Pishë-Poros (Vlorë) veçohen depozitimet e neogenit dhe të kuaternarit. Depozitimet e kuaternarit sipas gjenezës së tyre ndahen në deluvjale dhe aluviale. Depozitimet aluvjale të kuaternarit mbushin gjithë luginën e Vjosës. Përfaqësohen kryesisht nga subargjilat ngjyrë kafe të hapët me përbërje 5-15 % rërë të imët. Në thellësi argjilat gradualisht ndryshojnë ngjyrën në blu të errët dhe përmbajnë mbeturina organike, fakt ky që tregon karakterin lagunor të depozitimeve të mëvonshme të kuaternarit. Zona e Pishë-Poros (Vlorë) i përket rajonit të Ultësirës aluvionale bregdetare, i cili përfshin zonën bregdetare dhe ultësirat e deltave të derdhjes së lumenjve me zona me origjinë aluvionale dhe detare. Ky rajon ndahet në tre nënzona:

- 1. Zona bregdetare e plazheve;
- 2. Ultësira e hapur e sedimenteve fluvio-aluvionale;
- 3. Zonat e lagëta, lagunat, liqenet bregdetare të kripura.
 1. Nënzona e parë përfshin zonat bregdetare dhe koridoret dunale të sheshta ose lehtësisht të ngritura. Tokat dominante janë ato Arenosols.
 2. Nënzona e dytë përfshin zonat e ultësirës apo kodrinore shumë të buta, të cilat janë të bonifikuara tashmë. Kuotat e tyre variojnë nga 0 në 50 m lartësi nga niveli i detit. Tokat dominuese janë Fluvic Cambisols ose Fluvisols, me teksturë thellësisht ranore dhe mbi të gjitha me strukturë të dobët. Drenazhimi natural është i mirë edhe gjatë periudhës së dimrit.
 3. Nënzona e tretë përfshin depresionet bregdetare që më parë kanë qenë të mbuluar nga deti.

Në zonën e Pishë-Poros (Vlorë) vihen re këto tipe tokash:

- Tokat e kripura përbëjnë $\frac{1}{4}$ e zonës së mbrojtur dhe vendosen menjëherë pas brezit të dunave. Në këto toka është e përhapur një bimësi halofile e qëndrueshme ndaj përqëndrimit të lartë të kripës. Karakteristikë është dukuria e dinamikës së kripërave në muajt e ndryshëm të vitit. Vihet re se përmbajtja e kripërave në sipërfaqe shkon në raport të zhdrejtë me sasinë e reshjeve. Nivelet më të larta të kripës janë në muajt gusht-tetor dhe më të ulta në muajt prill e janar. Në verë kripërat lëvizin në drejtim të sipërfaqes dhe formojnë një cipë kripë në sipërfaqe, ndërsa në dimër vihet re shpëlarje masive e kripërave. Bimët barishtore më të përhapura janë kripthi (*Salicornia europea*), elbi i detit (*Hordeum maritimum*), fshesa (*Limonium vulgare*) etj. Ndër bimët drusore mbizotërojnë marina (*Tamarix parviflora*), shelgu (*Salix sp.*), plepi i bardhë (*Populus alba*) etj.
- Tokat ranore janë të përqëndruara përgjatë gjithë vijës bregdetare në zonën e marrë në studim dhe disa herë me shtrirje më në thellësi. Janë toka pa strukturë apo ku mungojnë horizontet, karakteristike për tipet e tjera të tokave dhe rezultat i veprimtarisë të valëve të detit dhe të lumenjve mbi depozitimet homogjene.
- Tokat ranore pak të zhvilluara janë më të përhapura në vende të ulta. Ato qëndrojnë të mbuluara me ujë për një kohë të gjatë. Karakterizohen nga depozitime ranore të mbuluara në sipërfaqe me një shtresë dheu ose subrëra prej disa cm trashësi. Në disa vatra formohen cipa argjilore të holla shumë të ngjeshura. Bimësia karakteristike është ajo kserofite, me karakteristika morfologjike e anatomike për tu përshtatur kushteve të temperaturave të larta të verës dhe mungesës së theksuar të ujit dhe kriprave minerale. Në përgjithësi në këto mjedise mbizotëron një bimësi e rrallë, që mbulon një pjesë të vogël të sipërfaqes.
- Tokat aluvionale vihen re përgjatë rrjedhjes së lumit Vjosë si dhe afër grykëderdhjes. Kanë ndërtim shtresor, si rrjedhim i depozitimeve të herëpashershme. Depozitimet afër shtratit të lumit kanë përbërje mekanike më të lehtë dhe janë më të varfra me lëndë ushqyese sesa ato që ndodhen larg tij. Formacionet aluvionale zakonisht karakterizohen nga dy shtresa. Në shtresën e parë vendosen depozitime shtratore (të njëjta me ato të shtratit të lumit) të përbëra

nga rëra, zhavorë e gurë. Në shtresën e dytë, që është mbi të parën, vendosen subargjilat dhe argjilat në formë brezash horizontal, trashësia e të cilëve ndryshon sipas vendeve. Tokat aluvionale mbajnë shumë lagështirë sidomos gjatë stinës së dimrit. Ato zakonisht kanë pak lëndë organike dhe humus (deri në 2%). Dominojnë subargjilat dhe argjilat.

- Tokat hidromorfe kënetore në zonën e mbrojtur formohen kryesisht nën ndikimin e faktorëve hidrologjik sikurse janë grumbullimi i ujrave të rreshjeve atmosferike në vendet e ulta, gropat dhe përmytjet e lumenjve.

4.3. Hidrologjia

Ujërat nëntokësore

Kompleksi është përgjithësisht i varfër në ujëra nëntokësore. Këto ujëra akumulohen në depozitime të cekta ranore; janë me cilësi dhe vëllim të ulët. Shpesh uji sigurohet me anë të puseve të gërmuara me dorë. Thellësia e ujërave nëntokësore varion nga 1-10 m. Rryma kryesore e ujërave nëntokësore është perëndimore në drejtim të detit Adriatik.

Për sa i përket Ujërave sipërfaqësore, drenazhuesi kryesor i zonës është lumi Vjosë që derdhet në detin Adriatik dhe lumi i Shushicës i cili është dhe tributar i lumit Vjosë. Kodrat e ulëta në lindje të kompleksit janë të lidhura me zgjerimin më verior të maleve të Kurveleshit. E gjithë toka bujqësore mbulohet nga një rrjet i dendur kanalesh ujitës. Por pjesa më e madhe e tyre janë sot të shkatërruar dhe për pasojë vetëm një pjesë e vogël e tokës është nën ujë. Zona ka tre hidrostatione dhe disa kanale me rrjedhje të lirë. Sistemi i drenazhimit nuk funksionon siç duhet për shkak të mbushjes së kanaleve, mos funksionimit të pompave, ndërprerjeve të energjisë elektrike etj. Gjatë shirave të dendur, pjesë të mëdha të tokës bujqësore përmyten për javë të tëra.



Figura 19 Sistemi Ujor në studim i zonës



Harta 8 rrjeti I ujërave mbitokësore, zona Vjosë Nartë, Burimi:MTM “Peisazhi i Mbrojtur “Vjosë-Nartë”

4.4. Rreziqet

Rreziku nga zjarri

Kjo zonë ka qënë e kërcënuar nga zjarri ndër vite, ku mund të përmendim zjarrin e rënë gjatë vitit 2016 në Ekonominë Pyjore “Pishë-Poro”. Ku rezulton se është përshkruar nga zjarri një sipërfaqe prej 555.4 ha pyll dhe është djegur një sipërfaqe prej 324.3 ha pyll.

Prona	E përshkruar (ha)	E djegur (ha)
Private	161.5	162
Shtetërore	393.9	162.3
Total	555.4	324.3

Tabela 1 Sipërfaqja e përshkruar dhe e djegur e pronave në PM Vjosë-Nartë

Përmbytjet

Nga shirat me intensitet të lartë që mund të bien në Qarkun e Vlorës ka shumë zona, fshatra dhe kultura bujqësore që mund të dëmtohen. Më të prekurat janë zonat që ndodhen pranë lumit Vjosë. Nga vërshimi i këtij lumi preken shume ferma bujqësore dhe blegtorale. Nga shirat e rëna vitet e fundit ka pasur dëmtime të konsiderueshme në kulturat bujqësore si bimët e arave, perime fushe, perime në sera, në frutikulturë vreshtari etj. Dëmtime janë shkaktuar dhe në blegtori dhe në bazën ushqimore të blegtorisë.


Tornado

Një rrezik tjetër i kësaj zone ka qënë dhe tornado e ndodhur në tetor të vitit 2016 ku shkatoi rrëzimin e një numëri të konsiderueshëm pishash. Në ekonominë pyjore “Kume-shashic” dhe pikërisht në afërsi të parcelave pyjore nr 5/c dhe nr 6 u numëruan rreth 60 copë pisha të rrëzuara me një lartësi mesatare 10-12 dhe diametër 20-30 cm.

Zonat bujqësore më të mundëshme për tu rrezikuar nga fatkeqsitë natyrore janë: Fshatrat që preken nga vërshimi i lumit Vjosë janë: Novoselë, Fitore, Bishan, Akërnë, Aliban, Mifol, Poro, Delisuf, Dëllënjë.

5. Biodiversiteti

Rajoni i Vlorës strehon afro 1400 bimë enësore, që përbëjnë 42% të florës së Shqipërisë. Vetë zona Vjosë-Nartë mendohet të ketë të paktën 800 bimë enësore (25 % e florës së Shqipërisë) duke përbërë sërish një zonë të rëndësishme për florën në Shqipëri. Zona e Pishë- Poros (Vlorë), është e pasur në florë dhe shoqërime bimore. Kjo është pasqyrim i kushteve të përshtatshme fiziko-geografike, topografisë, gjeologjisë etj. Por që kjo zonë të vazhdojë të ketë bimësi të pasur duhet mbrojtur dhe nuk duhet mbishfrytëzuar.



Harta 9 Vegetacioni në zonën Vjosë Nartë, Burimi:MTM “Peisazhi i Mbrojtur “Vjosë-Nartë”

Flora e kësaj zone është ngushtësisht e lidhur me habitatet që kjo zonë përmban ku përfshihen habitatet natyrore dhe ujore. Habitatet natyrore përbëhen nga tipe të ndryshëm njësisish ekologjike të klasifikuara në përputhje me kriteret funksionale dhe përshkrues si prania/mungesa e ujit, kripshmëria dhe fizionomia e bimësisë. Ndërkohë që habitatet ujore përbëhen nga shumë nënhabitat si ata ujore gjysëm të përhershme, kanalet e kullimit dhe të ujitjes, kënetat, rezervuaret me ujë të ëmbël dhe shtrati i lumit mbuluar nga pyjet aluvionale.

Pyjet aluvionale

Bimësia e këtij habitati ndahet në dy kate. Kati i parë përfaqësohet kryesisht nga kallamishtet dhe lloje të tjera të lidhura me ujërat. Sasia dhe mbulesa e katit të dytë varen nga niveli i përmytjeve. Në katin e parë, tipi kryesor i bimësisë përfaqësohet nga Klasa *Phragmitetalia*, ku shoqërimi mbizotëruar është ai me *Phragmites australis*. Ky shoqërim shfaq një plasticitet ekologjik mjaft të lartë dhe shtrihet nga brigjet e lumenjve deri në distanca të largëta prej tyre. Gjendet përgjatë kanaleve të ujitjes, në disa kanale kullues, në disa pjesë të lumit Vjosë ku rryma nuk është shumë e fortë.

Kati i dytë përfshin pyjet breglumore që i përkasin Klasës *Alno-Populetea* dhe *Salicetea purpurea*. Llojet kryesore të kësaj klase janë *Populus alba*, *Populus nigra*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix amplexicaulis*, *Salix elaeagnos subsp. angustifolia*, *Alnus glutinosa*, *Alnus incana*, *Platanus orientalis*, *Ulmus minor*, *Ulmus glabra*, *Fraxinus angustifolia*, etj. Bimësia barishtore është përgjithësisht e varfër. Llojet më të zakonshëm janë *Equisetum telmateia*, *Equisetum ramosissima*, *Prunella vulgaris* etj. Në disa pjesë të lumit, me rrymë të fortë dhe substrat zhavorror, pemët zëvendësohen nga lloje shkurretore si *Shelgu Salix* i shoqëruar me drurë si *Rrapi Platanus orientalis*, *Shelgjet Salix elaeagnos*, *Salix alba*, *Salix purpurea*, *Marina Tamarix parviflora*, etj. Në pjesën e poshtme të lumit, ku rryma është më e dobët dhe me substrat ranor dhe argjilor, bimësia dominohet nga *Alnus glutinosa*, *Fraxinus angustifolia*, *Ulmus minor*, *Quercus robur* (individë tepër të pakët e shumë të shpërndarë), *Populus alba* etj.

Dunat ranore

Kompleksi ligatinor i Nartës është i famshëm për dunat e tij ranore bregdetare disa prej të cilave arrijnë 6-8 metra. Dunat ranore dhe brezi ranor përgjatë vijës bregdetare janë të zhveshura nga bimësia deri në një gjatësi prej 30 m. Llojet fanerogame shfaqen të parat. Këto lloje pioniere përfshijnë *Cakile maritima*, *Xanthium strumarium subsp. italicum*, *Salsola kali* dhe lloje tipike të dunave si *Ammophila arenaria subsp. arundinaceae*, *Elymus farctus*, *Echinophora spinosa* etj.

Pylli i pishës

Pylli i pishës zë një sipërfaqe prej 1 200 ha, një pjesë e konsiderueshme e zonës së Nartës. Shtrihet paralelisht në sistemin dunor. Pishat janë mbjellë 30-40 vjet më parë për të stabilizuar vijën bregdetare nga erozioni. Ky formacion përfaqësohet nga disa lloje pishash ku më të zakonshmet janë *Pinus maritima*, *P. pinea* dhe *P. pinaster*. Kati shkurretor përfaqësohet nga lloje tipike mesdhetare si *Pistacia lentiscus*, *Erica manipuliflora*, *Myrtus communis* etj. Janë lloje karakteristike të Klasës *Quercetea ilicis*, klasë e cila mbulon 40-50 % të sipërfaqes totale. Midis këtyre komuniteteve bimore (vegjetacioni i dunave ranore dhe pylli i pishës mesdhetare), ka disa breza të kultivuar, të dominuar nga llojet e introduktuara të *Acacia saligna* (një pjesë e gjerë e brezit, pranë lumit Vjosë u dogj me 2003) dhe *Agave americana* (afro 200 m tek plazhi i Zvërrnecit).

Nga ana tjetër, në ishullin e Zvërrnecit, i vendosur në pjesën jugore të lagunës, mbulohet nga pylli gjethegjelbër i Selvisë *Cupressus sempervirens* (pemë 8-10 m të larta) në shoqërim me *Quercus*

ilex, *Quercus pubescens* dhe *Pinus spp.* Mbulesa bimore është mjaft e dendur duke aritur deri në 90-100 % të sipërfaqes së përgjithshme. Kati i shkurretave përbëhet nga lloje si *Myrtus communis*, *Pistacia lentiscus*, *Laurus nobilis*, *Rubus spp.*, *Phillyrea angustifolia*, *Olea olaster*, etj. Mbulesa bimore e këtij kati 1-2 m të lartë është 50–60%. Kati barishtor është i rrallë dhe me pak lloje si *Chrysopogon gryllus*, *Asparagus acutifolius*, *Dactylis glomerata*, *Desmazieria rigida* etj.

Me interes të madhë cilësohet sidomos prania e dy llojeve endemike: *Orchis albanica* dhe forma hibride *Orchis x paparisti*. 67 lloje (shih fig. Me poshte) konsiderohen si të vlefshme në zonën e Nartës për vlerat dhe interesin e tyre ekonomik dhe shkencor.



Figura 20 *Orchis albanica* dhe forma hibride *Orchis x paparisti*

Për sa i përket Faunës, zona strehon më shumë se 1% të popullatës rajonale, të shpendëve të ujit dimëruës me më shumë se 34 000 individë (Kriteri Ramsar është 20 000 individë).. Këto të dhëna janë të mjaftueshme për ta listuar Vjosë-Nartën si një nga zonat më të rëndësishme për shpendët në Shqipëri dhe Rajonin Mesdhetar Lindor.

6. Konkluzione mbi analizën e zones

6.1 Vështrim i përgjithshëm

- Zona dallon për vlerat e saj ekologjike, historike, dhe arkeologjike, larminë e habitateve dhe mozaikun e pejsazheve. Llojet me vlerë dhe habitatet e bëjnë atë shumë tërheqëse për edukim dhe ndërgjegjësim publik të nxënësve të shkollës, studentëve, publikut në përgjithësi dhe madje edhe vendim-marrësve.

- Prania e pesë Monumenteve Natyrore, Manastiri i Zvërnecit (një nga zonat më të vizituara, një atraksion shumë tërheqës për qytetin e Vlorës) dhe zonës arkeologjike të Treportit i japin të gjithë zonës vlera të tjera shtesë në aspektin kulturor dhe eko-turistik, duke e bërë atë të rëndësishme në shkallë lokale dhe kombëtare.

- Kjo zonë gërsheton një larmi kushtesh të përshtatshme për zhvillimin e turizmit si klimë të shëndetshme dhe kushte sociale e ekonomike të favorshme. Zona është e famshme për

pasuritë e saj natyrore dhe kulturore të cilat mund të mbeshtesin aktivitete eko-turistike të shumta të tilla si shëtitje (Kallënga dhe Rezervati i Menaxhuar i Pishë-Poros), vrojtime shpendësh në lagunën e Nartës dhe në Kriporet, turizëm kulturor në zonat historike të Zvërnecit dhe të Treporit.

- Vendndodhja e aeroportit të ri të propozuar për Shqipërinë e Jugut është vendosur në ish-aeroportin ushtarak në Mifol, afër fshatrave Akerni, Novosele dhe qytetit të Vlorës. Vendndodhja e propozuar për aeroportin e ri është afër Lagunës së Nartës, Liqenit të Kripur të Vlorës dhe lumit Vjosa. Në jug kufizohet me Lagunën e Nartës, rreth 5 km në peizazhin natyror të mbrojtur. Ana perëndimore kufizohet me bregdetin rreth 6.4 km larg fushës ajrore. Në anën lindore, rreth 200 metra larg, ndodhen disa shtëpi të ndërtuara së fundmi, pas mbylljes së aeroportit (98-99), ndërsa qendra e fshatit Akerni ndodhet rreth 500 m nga pika më e afërt e perimetrit në zona e ish aeroportit të Mifolit. Rreth 3 km larg pistës në drejtimin juglindor janë kriporet. Në anën veriore, kufizohet me lumin Vjosa 3.5. km, ndërsa derdhja e Vjosës është rreth 10 km. Burimet ujore në zonën e projektit nuk ndikohen nga emetimet industriale ose ndotjet e trashëguara mjedisore. Burimi i vetëm i ndotjes sipërfaqësore mund të jetë lumi Vjosa dhe Drino, për shkak të mbizotërimit të gurëve gëlqerorë në pellgun e tyre, janë ndër lumenjtë me erozion të kufizuar në Shqipëri. Kapaciteti sedimentar në rënie arrin 212 kg / sek, turbullimi mesatar është 1,087 g / m³ dhe modulet e mbeturinave janë 997 ton / km në vit. Uji i Vjosa Drino ka një mineralizim mesatar respektivisht prej 335 mg / L dhe rajonit / litër 286 mg. Ato janë burime uji me karstikë të shkëlqyeshme në burimet rurale të Viroit, Libohova Kelcyra dhe ujë të ftohtë në Tepelenë. Përveç këtyre burimeve, ka shumë të tjerë më të vegjël dhe dhjetëra rrjedhje përrenjsh që rrjedhin në lumenjtë Vjosa dhe Drinos. Ata vazhdimisht rrjedhin dhe i mbushin ato. Prurjet më të mëdha të ujit ndodhin në lumenj gjatë periudhave të reshjeve dhe në muajt kur reshjet e dëborës shkrihen. Lumi pasuron rrjetin hidrografik të rajonit me ujë. Terreni është zakonisht malor. Në zonat e larta malore, kodrat e larta, me modele të rregullta të erozionit, dallohen si monumente natyrore me vlera gjeoshkencore. Klima në rajon është tipike mesdhetare me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë, me përjashtim të zonës nga Kalivaç deri tek ura Mifoli e cila karakterizohet nga një verë e ngrohtë, pa borë dhe dimra. Në këtë rajon, reshjet mesatare në 1700-1800 mm shi në vit. Pellgujuëmbledhës i Vjosës në të cilin projekti do të zhvillohet në përputhje me vlerat mesatare të monitorimit, klasifikohet si në gjendje të mirë - Klasa II

6.2 Sistemi ujor

Poro është një vend unik i cili ka vendbanime të rëndësishme si grykëderdhja e lumit Vjosa dhe laguna bregdetare. Këto zona janë të rëndësishme si një habitat për zogjtë migratorë. Për këtë arsye ai ka një status mbrojtjeje (Parku Kombëtar IUCN Kategoria II). Zona është përgjithësisht e dobët në ujërat nëntokësore. Këto ujëra grumbullohen në depozita të cekëta me rërë; janë me cilësi të ulët dhe vëllim të ulët. Rrjedha kryesore e ujërave nëntokësore është perëndimore drejt Detit Adriatik. Kullimi kryesor i zonës është Lumi Vjosa që derdhet në Detin Adriatik. Gjithashtu në zonën Pishë-Poro janë renditur neogjenet dhe depozitat kuaternare. Depozitat kuaternare sipas gjenezës së tyre ndahen në delivuale dhe aluviale. Depozitat aluviale të kuaternarit mbushin tërë luginën e Vjosës. Ato përfaqësohen kryesisht nga një përzierje e lehtë me 5-15% përbërje rërë të imët. Në thellësi, balta gradualisht ndryshon ngjyrën në blu të errët dhe përmban mbeturina organike, një fakt që tregon karakterin e lagunës së depozitimeve të mëvonshme kuaternare.

6.3 Sistemi i gjelbërt, natyror

Larmia bimore e kësaj zone përcakton karakteristikat mjedisore që lidhen me njëra tjetrën, siç janë prania e rërës, thatësisë ose ujit të bollshëm (pellgje dhe laguna) dhe kripëzimi i tokës. Sipas karakteristikave mjedisore, në këtë zonë gjejmë bimësi të shkurreve (psamo- dhe psamonitrofile), bimësi të kënetave të kripura (halo- dhe halohigrofile), bimësi të shtretërve të poshtëm të lumenjve dhe gjithashtu të ujit të freskët (hygo-hygrohydrophilic) dhe bimësi pishe bregdetare. Kjo zonë është gjithashtu e pasur me bimë aromatiko-medicinale, ku gjenden rreth 112 lloje bimësh të ndryshme. Bimësia e zonës Pishë-Poro (Vlorë) është në dinamizëm të vazhdueshëm. Aktualisht, zona po shndërrohet në një qendërkryesore transporti të integruar. Një rrjet hekurudhor ndërkombëtar midis zonave kryesore urbane është gjithashtu në ndërtim e sipër.

- Bimësia e dunave dhe fushave bregdetare (psamo- dhe psamonitrofile).

Është bimësia afër detit, prapa rrjedhës së ngushtë të rërës pa bimësi. Kjo përcakton kryesisht një nga veçoritë specifike të këtij mjedisi.

- Bimësia e pishave bregdetare.

Përfaqësohet nga pylli Pishë-Poros. Ai ka karakteristikat e një pylli me të vërtetë mesdhetar me të gjithë elementët përbërës dhe strukturës së tij të maturuar. Lloji mbizotërues është pisha e egër (*Pinus halepense*), e cila krijon një shoqërim bimor me *Pistia lentiscus*, *Myrtus communis* dhe *Erica manipuliflora*. Në pjesën jugore është mbjellë pisha e butë.

- Bimësia halohigropilike (kënetat e kripura).

Megjithëse sipërfaqja e saj është ulur për shkak të shkrirjes dhe korries së tokës bujqësore nga reklamimi, ajo ende ka një sipërfaqe relativisht të madhe të bimësisë bregdetare me bar. Në tokat e kripura mund të dallojmë: mbjellës pionierë njëvjeçarë me *Salicornia europaea* dhe me *Suaeda maritima*, shoqatat e bimëve u stabilizuan me *Arthrocnemum*.

- Bimësia higro-higroskopike

Për shkak të prerjeve dhe dëmtimeve në të kaluarën, sot kjo bimësi ka një formë hije-barishtore dhe shpesh paraqitet në formën e shoqatave të thjeshta bimore (oligocenoza) si ato të *Tamarix parviflora*, *Vitex agnus-castus*, *Platanus orientalis*, *Phragmites australis*, etj. dhe *typha latifolia*. Nga bimësia higro-higroskopike dallojmë dhe shoqërojmë bimët me *Scirpus lacustris*, *Carex elata* dhe *Saccarum ravennae*.

- Bimësia e përmbytjes

Kjo bimësi është e vendosur kryesisht në tokat aluviale, të cilat janë të përhapura në formën e njollave, por sipërfaqja e saj shtohet si rezultat i lënies së një pjese të tokave të patrajtuara. Ato janë me interes dhe për vlerat aromatike - mjekësore të specieve përbërëse bimore që ato kanë me të cilat është e pasur. Ndër këto janë shoqatat bimore me *Ranunculus sardous* dhe *Dittrichia viscosa-Cichorium intubus*.

6.4 Propozimet territoriale

Propozimet territoriale jepen **në zbatim të orientimeve strategjike të Planit të Përgjithshëm Kombëtar**, Planit të Integruar Ndërsektorial për Bregdetin si edhe duke rivlerësuar parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Vlorë.

PDZRK propozon përdorimet e detajuara për zhvillime në funksion të turizmit bregdetar dhe ekoturizmit duke përfshirë në parashikimet e tij edhe investimet strategjike nga niveli kombëtar e sektorial i qeverisjes.

Propozimet territoriale në zonën e Vjosë-Nartë, vijnë si rezultat i zhvillimeve të fundit strategjike për vendin në fushën e transportit ajror dhe zhvillimit të turizmit ; hartimi dhe miratimi i masterplanit, për ndërtimin e aeroportit të tretë ndërkombëtar në fushën e Mifolit, pranë fshatit Akërnë si edhe strategjia për zhvillimin e turizmit në vend si një nga degët kryesore të ekonomisë.

Ndërtimi i aeroportit të ri, jo vetëm do të shndërrojë Vlorën në një pol të rëndësishëm për Shqipërinë por edhe për Ballkanin Jug-Perëndimor. Kjo qendër e rëndësishme urbane, do të shndërrohet në një nyje transporti multimodal, të cilat priten të ngrenë në nivele të reja turizmin, shkëmbimet tregëtare dhe disa degë të tjera me rëndësi të ekonomisë në tërësi.

Për infrastrukturën e transportit, sistemi rrugor i propozuar i PDZRK mbështetet në propozimet e PPV Vlorë por rikonfiguron në një pjesë të sistemit modelin e qarkullimit, sugjeron akseset e përshtatshme në zonën aeroportuale dhe zonën e re turistike për zhvillim, shton brezat e gjelbërimit në anë të akseve dhe korsitë e biçikletave.

Zhvillimet e synuara në zonë për PDZRK në hartim, nuk prekin të gjitha njësitë strukturore. Pjesa e fshatrave tradicionale si : Poro, Novosele, Akërnë, etj. të marra në studim, identifikohen brenda sistemit urban me treguesit e parashikuar nga PPV Vlorë. Në çdo rast, vija kufizuese urbane e fshatrave tradicional nuk peson zgjerim. Plani i detajuar për këtë zonë të rëndësishme kombëtare, në përgjithësi synon:

1. Të integrojë në një zhvillim multidimensional investimin strategjik për aeroportin e tretë ndërkombëtar të vendit.
2. Të rrisë në mënyrë cilësore ofertën turistike akomoduese të qytetit të Vlorës.
3. Të ofrojë hapësira publike rekreative të aksesueshme dhe me dizajn bashkëkohor që zgjidh problemet e aksesit në zonë, respekton ndjeshmërinë mjedisore të zonës dhe mbështetet në materiale tradicionale ndërtimore.
4. Të sugjerojë nëpërmjet dizajnit urban, peizazhistik dhe infrastrukturor, zgjidhje të qëndrueshme për sa i përket shmangies së erozionit bregdetar.

1 – Plan propozimi ka për qëllim rihzhvillimin e tërë ligatinës me interes të madh natyror për larminë e bimësisë dhe kafshëve të egra, është e nevojshme të eliminohen shenjat/demarkacionet e çdo rrethimi ekzistues kufizues. Një mundësi projektimit është, zëvendësimi me një kufi që ka më pak ndikim vizual dhe fizik për përdoruesit, duke e bërë atë pothuajse transparent në lidhje me rrjedhën e ujit, specieve të kafshëve dhe bimëve.

2 - Aksesit përgjatë bregdetit: mund të shihet si një mundësi dhe jo thjesht si një shenjë kufizuese apo një objekt i thjeshtë me funksionin e vetëm të ruajtjes së territorit. Projekti propozon një rikualifikim dhe ri-funksionalizim, duke krijuar një shteg që çon vizitorët përgjatë tij në zemër të Pyllit të Pishave, dhe deri në Manastir. Rruga ciklistike dhe e

këmbësorëve mund të vendoset në lartësi të ndryshme. Kjo na lejon të përcaktojmë një zbulim të ligatinës nga pika të reja, të ndryshme të rrugës, pa hyrë në konflikt me hapësirën e mbrojtur, por duke shijuar bukurinë dhe veçantinë e saj.

3 - Pishat: Pylli i pishës është i dëmtuar, veçanërisht në pjesën afër vijës bregdetare, për shkak të veprimit eroziv të detit dhe ajrit të detit që djeg pemët që qëndrojnë mbi duna, tani të konsumuara nga veprimi i erës dhe ujit. Para së gjithash, është e nevojshme të rivendoset brezi i dunës, i cili lejon mbrojtjen e Pyllit të Pishave, i cili më pas mund të rizhvillohet përmes mbjelljes së pemëve të reja. Pemët tani të dëmtuara në mënyrë të pariparueshme mund të përdoren, së bashku me materialin bimor të transportuar nga lumi në plazh, si një material konsolidimi i dunave për të mbrojtur Pyllin e Pishave që shtrihet pas. Këto duna më pas mund të mbillen me bimësi të përshtatshme, në mënyrë që t'i rikthejnë ato në një situatë të qëndrueshme që lejon mirëmbajtjen dhe lëvizjen natyrore me kalimin e kohës dhe mbrojtjen natyrore në det.

4- Pikat panoramike dhe pasazhet: Kordoni lindor i dunës përballë grykës së lumit është në një gjendje më të mirë konservimi sesa dunat në pjesën ballore të bregdeti. Midis vegjetacionit është e mundur të gesh disa shtigje, të cilat sidoqoftë kanë nevojë për mirëmbajtje dhe të bëhen pjesë e një rrjeti më të gjerë të shtigjeve që lidhin brendësinë e Pyllit të Pishave me ripin bregdetar dhe gjithë sistemin e dunave. Kjo do të lejojë të kemi pamje ideale të lagunës dhe të zbulojmë bimësinë e zonës në thellësi.

5- Pikat e ankorimit: Mundësia e krijimit të një porti detar për atraksionin e turistëve që dëshirojnë të vizitojnë pyllin me pisha dhe manastirin është konkrete dhe besohet se kjo është e mundur me kusht që porti të mundësojë, në kushte optimale të motit, një ankorim të sigurt të paktën për kohëzgjatjen e vizitave. Prandaj u konsiderua se ai duhet të jetë i vendosur në një pozicion afër zonës së interesit, por pa penguar trafikun detar.

6.5 Përdorimi i propozuar i tokës dhe ndarja e njësive në nënnjësi

Ndarja e njësive strukturore në nënnjësi dhe organizmi i tyre bëhet me qëllim orientimin e zhvillimit të zonës që t'i përshtatet territorit, masave mbrojtëse e kushtëzimeve si dhe kërkesave të sektorit të turizmit për zhvillim.

Njësitë strukturore në studim i nënshtrohen procesit të ndarjes në nënnjësi strukturore mbi bazën e të cilave kryhet procesi i zhvillimit të tyre. Kjo ndarje e njësive strukturore reflektohet në përdorimet e propozuara të tokës dhe në kushtet e propozuara të zhvillimit.

Modeli i propozuar për nëndarjen e njësive strukturore bazohet në trajektoret e sugjeruara nga terreni në studim. Një tipar i dallueshëm që shënjon territorin janë kanalet ekzistuese të drenimit. Në këtë mënyrë, grupi i projektimit ka propozuar nëndarjen e parcelave dhe pjesën më të madhe të sistemit rrugor paralel me këtë rrjet këndrejt të propozuar nga relievi ekzistues.


Projekti është i ndarë në tre përdorime programore: bashkëjetesën midis zonave të banimit dhe të bujqësisë; planifikimin e një rrjeti rrugor sipas një rrjete lindje-perëndim/veri –jug; dhe nëndarjen e zonave të mbetura në makrozona funksionale. PDZRK fokusohet tek një projekt “pa ndërtime” i cili mbështet zonat e tjetërsuara nga njeriu përmes një shpërndarjeje racionale në zonat natyrore. Objektivi është i dyfishtë për maksimizimin e një jete urbane cilësore dhe të qëndrueshme dhe njëkohësisht, për minimizimin e impaktit mjedisor në territorin përreth duke u përqendruar në marrëdhënien midis objektit dhe natyrës përmes një strategjie të rehabilitimit të

ekosistemit ekzistues. Projekti implementon një sistem të gjelbër që sillet si shtylla kurrizore e vendbanimeve të reja. Akoma më tej, mjedisi i ndërtuar ndjek peisazhin natyral duke përcaktuar lartësinë e objekteve në përputhje me peisazhin kodrinor.


6.7.1 Sistemet bazë të territorit

PDZRK Vjosë Nartë propozon planifikimin e sistemeve të territorit sipas hartës së mëposhtme. Ashtu si mund të vihet re, pjesa më e madhe e territorit sugjerohet të ruajë karakteristikat ekzistuese në sistemin ujqor dhe sistemin bujqësor. Ndërkohë, sistemi natyror përqëndrohet kryesisht në zonat përreth sistemit ujqor, përkatësisht brigjet e shtratit të lumit Vjosë, brigjet e shtratit të vjetër të lumit Vjosë si edhe zonat natyrore të bregut të detit të lidhura me territorin e ndarë mës ujit të ëmbël dhe ujit të kripur.

Sistemi urban është i përqëndruar brenda kufijve të fshatrave ekzistues, si edhe propozohet në mënyrë të kufizuar për zhvillimin e zonës turistike. Ashtu si do të vihet re edhe nga tabelat e përdorimit të detajuar dhe treguesëve të zhvillimit, këto propozime turistike ruajnë vlera të ulëta të treguesve të zhvillimit dhe shoqërohen me një shpërndarje të balancuar mes zonave natyrore dhe të zhvillimit.



Harta 10. Harta e Sistemeve Bazë të territorit



Harta 11. Harta e Përdorimit të propozuar të tokës

6.7.2. Përdorimi i tokës sipas njësive strukturore

Njësitet strukturore të sistemit Bujqësor

Të gjitha njësitet e sistemit bujqësor, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë.

Njësitet strukturore të Sistemit Natyror

Të gjitha njësitet e sistemit natyror brenda kufirit të zonës së PDZRK Vojsë-Nartë, me përjashtim të atyre të cilësuar në tabelën e mëposhtme, ruajnë kufijtë dhe përdorimet e parashikuara nga PPV Vlorë. Në përgjithësi, në njësitet strukturore me përdorim natyrë nuk lejohen zhvillime të asnjë lloji, megjithatë nuk përjashtohen vendosja e strukturave të lehta të përkohshme për ofrimin e disa aktiviteteve dhe shërbimeve pranë zonave të plazhit.

Njësitet strukturore të Sistemit Bujqësor me shërbime agroturistike.

Këto njësi kanë përdorim bazë bujqësi dhe natyrë, megjithatë nuk përjashtohen disa aktivitete shërbimi. Territori i këtyre njësive shtrihet në sipërfaqe krejtësisht të pashfrytëzuara dhe shërben si një kalim gradual midis përdorimeve bujqësore dhe turistike. Përgjithësisht janë konceptuar të zhvillohen në formën e fermave të mëdha bujqësore të cilat mund të zhvillojnë aktivitetin e agroturizmit, vinotekave etj. Kështu këto ferma mund të specializohen në prodhimin dhe përpunimin e një produkti të vetëm dhe njëkohësisht të shërbejnë si vende atraksioni për kalimin e kohës të turistëve të zonës apo edhe qytetarëve nga Tirana Vlora dhe më gjerë. Zhvillimi i vinotekave, i fermave me pentari të ndryshme apo të hipizmit etj ...do të shndërrojë zonën jo vetëm në prodhuese por edhe një markë për vendin. Brenda fermave mund të përfshihen aktivitete të shërbimit, restorantit dhe pjesërisht hoteleri për të plotësuar ciklin e aktiviteteve brend apartelave të mëdha që shkojnë nga 5-10ha për territoret më pranë detit deri në 50-100 ha për fashën qendrore të të gjithë zonës në studim.

- 1 *Kategoria bazë* – Bujqësi dhe Natyrë
- 2 *Nënkategoria* - Agroturizëm, Ekoturizëm
- 3 *Funksioni* – Ferma, Bujtina, Bar, Restorant, njësi akomodimi



Figura 21 Modeli i përdorimit dhe zhvillimit të Sistemit Bukqësor



Figura 22 Aktivitetet natyrore dhe kombinimi i sistemit natyror*




Figura 23 Modelet e zhvillimit të Sistemit Bujqësor, zhvillimi i Agroturizmit*

6.7.3. Plani i infrastrukturave teknike

Kryesisht sistemet e infrastrukturës teknike (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), do të vendosen në sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, çdo sistem do të qendrojë me vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të ndërpritet nga një sistem tjetër si psh., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa fshatra sot. Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtësojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese. Lidhjet me rrjetin duhet të bëhen në korridoret sekondarë më të afërtë linjës kryesore qendrore. Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujit të pijshëm, të parametrave kimike dhe mikrobiologjike duhet të bëhet në vazhdimësi në stacionet e pompimit, si edhe në pikat fundore të çdo degëzimi sekondar.

Relievi i Nartës është faktor përcaktues për sistemin e kullimit të gjithë zonës. Si një nga zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat e identifikuara me rrezik për përmbajtje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, në sipërfaqe për të parandaluar çdo përmbajtje të zonave të ulta.



Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe infrastrukturave. Burimi: PPV Vlore

6.7.4. Infrastruktura rrugore

Rrjeti i rrugëve parësore. Vlora është në një distancë prej 140 km nga Tirana dhe është e lidhur me rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet rrugës kombëtare Levan-Vlorë Sh8 dhe në Jug, me rrugën e Bregut nëpërmjet Qafës së Llogarasë (Sh8). Rruga transballkanike me gjatësi 2.5 km me status rrugë primare interurbane, e lidhur së fundmi me rrugën kombëtare Levan Vlorë jep mundësi për zhvillimin e potencialeve të portit dhe ka ulur efektin e mjeteve të rënda në trafikun e rrugëve të brendshme të qytetit. Po zhvillohet by-pasi i Vlorës që lidh autostradën Levan - Vlorë Sh8 me rrugën nacionale bregdetare Vlorë-Sarandë, pjesa jugore e Vlorës. Gjatësia e këtij aksi është 29 km dhe fillon në rrethrotullimin në fund të rrugës Levan-Vlorë dhe shmanë qytetin duke kaluar në Veri të tij duke përfunduar në Orikum.

Rrjeti i rrugëve dytësore. Vlora ka rreth 193 rrugë dytësore në gjendje relativisht të mirë. Një pjesë e rrugëve dytësore sidomos ato që lidhen me bregun janë të rikonstruktura dhe në gjendje të mirë ndërsa pjesa tjetër që lidhet me pjesën malore janë nën ndërtim me fond të FSHZH.

Rrjeti rrugor është një pjesë integrale e rëndësishme, pasi lidh zona të ndryshme duke filluar që nga bashkitë mes tyre, deri tek qytetet e fshatrat, duke lehtësuar lëvizjen mes njerezve, automjeteve dhe mallrave.

Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë, karakterin, llojin e shërbimeve që ajo ofron sipas zones ku ajo kalon, funksionin dhe qëllimin.

Hierarkia rrugore. Hierarkia rrugore e detajuar më poshtë është e bazuar në dispozitat e kuadrit ligjor shqipëtar, dhe i referohet projekteve ndërkombëtare dhe standarteve funksionale, me një qëllim të veçantë për t'u përshtatur me karakteristikat e veçanta të bashkisë Vlorë. Kjo hierarki është projektuar për t'u shërbyer vëllimeve të ndryshme të trafikut, në përputhje me përdorimin. Një vëmendje e veçantë gjatë planifikimit të rrugëve i është kushtuar dhe shmangies së turbullimeve të ekosistemeve të lagunave dhe zonave me sensibilitet të lartë mjedisor, si dhe kontrolli i flukseve të vizitorëve sipas parimeve ekologjike të planifikimit.

Rrjeti interurban. Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në të gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësitë e udhëtimeve, duke filluar nga autostradat në zinxhirët e rrugëve të vogla rajonale të qendrave të vogla urbane dhe fshatrat, duke ndikuar relativisht në kufijtë e moderuar të shpejtësisë. Në kuadër të Planit, rrugë interurbane mendohen të jenë:

Rruga kryesore interurbane është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime, autostrada me shpejtësi të lartë. Në këtë kategori përfshihet rruga e re nacionale Fier-Vlorë e cila përshkon sektorin verior të territorit të njësisë në anën e lagunes që të çon për në qytetin e Vlorës. Kjo është një rrugë e gjerë e projektuar si autostrada e mbyllur me dy korsi në çdo drejtim. Vazhdimi i saj është në formën e një rruge unaze që kalon përgjate kodrave mbrapa qytetit të Vlorës me karakteristikat e një rruge të ngushtë (një korsi për çdo anë me një gjërësi për shpejtësi mesatare 70-80km/orë).


Rruga dytësore interurbane, rrugë me një ose dy kalime që përbëjnë lidhjet primare të rrugës kombëtare me vendbanimet dhe plazhet. Në këtë kategori ka tri lidhje radiale që bashkojnë sektorë të ndryshëm të territorit të Bashkisë me sistemin nacional rrugor. Rruga e vjetër

nacionale nga Fieri krijon lidhjen e fshatrave veriore (Panaja, Bestrovë etj) me rrugën e re kombëtare (në dalje të Panajasë) dhe Novosela.


Arteria e dytë është lidhja me rrugën e unazës në pozicionin nga Babica në Sherishtë dhe nga aty në kufi me Bashkinë duke lidhur fshatrat me pjesën lindore të saj dhe me unazën e karakterizuar edhe nga përqëndrimi i aktiviteteve ekonomike. Rrugët janë me dy korsi me një gjerësi prej 7-9 m. Aksi i tretë është lidhja e re direkte nga rruga kombëtare për tek plazhi i Zvërnecit, në të cilën është propozuar edhe një dalje e re nga fshati i Nartës. Ky është projektuar me dy segmente të veçanta. Në zonën fushore kjo rrugë ka gjerësi 9 m, ndërsa në hyrje të Pyllit të Sodës, reduktohet në gjerësinë 7m.

Rrugët terciare interurbane janë rrugë të vetme, rrugë me një ose dy kalime me standarte më të ulëta të projektimit dhe të shpejtësive të trafikut, të cilat lidhin vendbanimet individuale me njëra-tjetrën dhe plazhet. Një rrjet i rrugëve terciare interurbane me karakteristika uniforme (gjerësi prej 5.75 m) është projektuar në formën e një rruge piktoreske për vizitorët që të lidhë të gjitha fshatrat duke shmangur qytetin e Vlorës dhe rrugën nacionale.

Rrugët lokale janë të gjitha rrugët e tjera jashtë kufijve të vendbanimeve (të shtruara ose të pashtruara) të cilat nuk janë prioritet i Planit dhe nuk përbëjnë një rrjet të caktuar.




Autostradë (A)




Rrugë interurbane kryesore (D)

Rrugë interurbane dytësore (C)



Rrugë interurbane dytesore (C)




Rrugë lokale (F)




Rrugë urbane kryesore (D)



Rrugë urbane kryesore (D)




Rrugë urbane dytësore (E)




Rrugë urbane dytësore (E)



Rrugë lokale (F)



Rrugë lokale (F)



Harta 10. Infrastruktura rrugore e propozuar

6.7.5. Infrastruktura e ujësjetës

Vlerësimi i rrjetit hidrografik dhe burimeve nëntokësore të ujit në zonë, i kapaciteteve të tyre dhe mundësitë për projekte në perspektivë të zhvillimit të infrastrukturës ujore, janë bazuar në studimet ekzistuese, PPV Vlorë si edhe në disa studime të kohëve të fundit.

Burimet ujore në zonën e studimit duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që të përmbushin kërkesat në rritje nga rrizhvimimi i parashikuar i zonës në banim, shërbime dhe turizëm. Edhe intensifikimi i përdorimit të tokave bujqësore, gjithashtu kërkon shtim të kapaciteteve për ujitje të tyre.

Situata hidrologjike në përgjithësi na paraqet kuadrin e një numër rrjedhash ujore, ku uji i pishëm kryesisht merret nga burimet e shumta nëntokësore që përshkojnë pjesën jugore të qytetit Vlorës, më të rëndësishmit ndodhen në zonën e Ujit të Ftohtë (Tyneli), në zonën pas Vilave dhe tek Kalaja.

Këto burime nëpërmjet pompave kalojnë ujin nga zona e Ujit të Ftohtë në lagjet kryesore të qytetit e më pas nëpërmjet rrjetit shpërndarës kryhet furnizimi me ujë. Rrjeti i shpërndarjes ka humbje të shumta.

Shërbimet e furnizimit me ujë në zonën e projektit duhet të zgjidhen në një fokus më të gjerë hapësinor, ekonomik dhe teknik dhe jo duke u përqendruar në çdo njësi në veçanti. Zgjidhjet e veçanta dhe lokale duhet të mbështeten dhe të zbatohen, duke ju referuar zgjidhjes përfundimtare të të gjithë territorit të bashkisë Vlorë, ose edhe më gjerë, gjithmonë nëpërmjet studimeve të thella dhe të detajuara të burimeve ujore, jo vetëm në zonën e bashkisë Vlorë. Ky koncept do të çojë në përdorimin më të mirë të mundshëm të pasurive ujore për zhvillimin e duhur perspektiv të këtij territori.

Uji inxjerrë nga pusët e cekëta shtetërore dhe private të hapura, është shpesh i ndotur për shkak edhe të efekteve infiltruese të ujërave të zeza, duke bërë që direktivat përkatëse të BE-së 80/778/EEC dhe 98/83/EEC të mos jenë plotësuar deri më sot. Kjo situatë rrezikon drejtpërdrejtë dhe në vazhdimësi në shëndetin e njeriut, prandaj kërkon t'i jepet prioritet i lartë kapërcimit të këtij problemi.

Është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, për të mbuluar sa më shumë të jetë e mundur zonat e populluara.

Aktualisht duhet propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe atyre të parametrave të cilësisë së ujit (p.sh. përcaktimit të vendeve dhe kohës për marrjen mostrave të ujit, CSB, E.coli). Në këtë mënyrë mund të zbutet pakënaqësia për cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë.

Infrastruktura e ujit të pishëm


Njësia administrative Novoselë identifikohet si një zonë ujëmbajtëse me kapacitet të lartë të mundësive të prodhimit të ujit të pijshëm jo vetëm për nevojat e popullatës por edhe me mundësi të furnizimit të fshatrave të komunës Qendër si dhe të qytetit të Vlorës. Ajo furnizon dhe fshatin Aliban dhe Akërnë. Novosela e merr furnizimin direkt nga rrjeti. Po kështu fshatrat

Çerkovinë, Skroftinë e Mifol e marrin nga daljet që janë lenë në linjën e dërgimit të Panajasë. Trevllazeri furnizohet nga depoja që e merr ujin nga stacioni i pompave në Skroftinë.

Zëvendësim dhe përmirësim i tubacione kryesore për shkak të kohës së gjatë të shërbimit. I nevojshëm shpimi i puseve të reja.

Në vitet e fundit është investuar për përmirësimin në gjendjen e infrastrukturës të ujit të pishëm të njësive ku është realizuar edhe rikonstruksioni i ujësjellësit Delisuf, Mifol, Novosele, Çerkovinë, Panaja dhe Skroftinë

Problematika e furnizimit me ujë për këtë njësi konsiston në sigurimin e kapacitetit prodhues të stacionit të ujit. Në këtë mënyrë garantohet furnizimi i popullatës në prespektivë dhe sigurohet sasia e nevojshme e ujit të pijshëm për strukturat e ardhme të turizmit dhe të aktiviteteve prodhues, që do instalohen në zonë.



Rrjeti i furnizimit me ujë të pishëm të propozuar Burimi PPV Vlore

6.7.6. Infrastrukturat e kanalizimeve dhe ujërave të ndotur dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta

Territori i zonës në studim mbulohet pjesërisht nga një rrjet i kanalizimeve i ujërave të ndotura, pjesa tjetër shfrytëzon sistemin e gropave septike. Me zhvillimin e parashikuar të zonës, si nga pikpamja e infrastrukturës ashtu edhe të ekoturizmit, është e domosdoshme ndërtimi i rrjetit të UKZ paralelisht me sistemin e infrastrukturës rrugore. Studimi gjithashtu planifikon vendosjen e një impianti të trajtimit të ujërave të ndotur ref.hartes se perdorimit te propozuar te tokes.

Në sistemin e kanalizimeve të qytetit Vlorë invesimi kryesor ishte projekti në kuadrin e programit PHARE, i cili përfshinte ndërtimin e kolektorëve kryesorë të ujërave të zeza (me diam që varion 800 -1000 – 1200 mm) dhe sistemin e trajtimit të tyre. Për këtë sistem janë ndërtuar 6 stacione

pompimi dhe nëstacione elektrike që shtynë drejt hidrovorit mbetejet e qytetit. Sistemi sot është pjesërisht në funksion. Ndërkohë u ndërtua sistemi i trajtimit të ujrave të zeza, i cili ende nuk është në funksion. Faza e dytë e projektit mundësoi lidhjet e zonës nga akademja deri tek 7 pallatet, rrjeti sekondar me atë kryesor, si dhe i njëjti zbatim për zonën e Skelës. Pritet të zbatohet faza e tretë dhe e katërt që parashikon lidhjet e rrjetit sekondar në zonat e rrugës transballkanike, aviacionit, lagjes 1 maj, 24 maj, Qeriba Derri e Bashkimi.

Sistemi i kullimit

Zona ka stacione pompimi dhe disa kanale me rrjedhje të lirë. Hidrostacioni i Vlorës gjendet në jug të kufijve të kompleksit lagunor. Ai kullon një sipërfaqe prej 1 000 ha. Kapaciteti pompues është afërsisht 16 000 l/s. Uji shkarkohet në det. Pastrimi i kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin kullues. Ndërtim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotura dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike në Nartë është i domosdoshëm.

Sistemi i ujitjes

Rezervuarët e ujërave të ëmbla që gjenden në fshatrat e Vlorës (si në Bestrovë, Zvërnec, Novosele,

Poro etj) kanë një rëndësi të dyfishtë për zonën. Së pari shërbejnë si i vetmi burim uji i ëmbël për faunën dhe së dyti edhe si burim uji për ujitje për tokat. Pastrimi i kanaleve lidhëse me detin dhe shtimi i ujërave të ëmbla do të përmirësojnë ndjeshëm situatën

Sistemi i vaditjes

Stacioni i Gorricës gjendet në pjesën lindore të Nartës. Ai drenazhon një sipërfaqe prej 1 000 ha. Kapaciteti pompues është afro 16 000 l/s. Uji derdhet në lagunë.

Njësia administrative Novoselë - Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Trevllazër, Çarkovinë, Skroftinë, Akërnë: Ndërtim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotura dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

Novoselë: Përmirësim i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotura.

Fitore, Aliban: Rikonstruksion i rrjetit të infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe kontroll i kushteve teknike të gropave septike.

Janë bërë disa investime të mëparshme për zgjerimin e rrjetit në fshatrat e njësive si:

- Ndërtim KUZ Fitore
- Ujëra të bardha Mifol
- Kanalizim i Ujrave të bardha në fshatin Fitore


Iniciativat e qeverisjes qendrore momentalisht janë fokusuar në zgjidhjen e problemit të ujrave të zeza për qendrat e mëdha urbane dhe është i nevojshëm krijimi e hapësirave teknike për ndërtimin e impianteve purifikuese të ujrave të zeza.

Sistemi i kullimit

Hidrostationi i Akërnisë ka një kapacitet pompimi prej 11 000 l/s dhe kullon 6 500 ha. Gjendet në pjesën veriperëndimore të kompleksit lagunor. Pjesa kryesore e ujit hidhet në det dhe një pjesë e vogël hyn në pjesën lindore të Nartës. Pastrimi i kanaleve të kategorisë së dytë dhe të tretë do të përmirësojë ndjeshëm kapacitetin kullues duke shmangur kështu edhe rrezikun e përmytjeve.

Sistemi i ujitjes

Kanalet vaditëse të pamirëmbajtur për 25 vjet, vetëm vitin e fundit kanë filluar të pastrohen. Nevojiten ndërhyrje për mirëmbajtjen dhe pastrimin e këtyre kanaleve për të rritur pjellorinë e tokës.



Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar PPV Vlore

6.7.7. Infrastrukturat e enegjisë elektrike dhe të teknologjisë së informacionit

Qyteti aktualisht mbulon nevojat për energji nga:

- Nënstationi Vlora 1 110/35/20/6kv;
- Nënstationi Vlora 2 110/20kv;
- Nënstationi Uji i Ftohte 35/6kv;

- Nënstacioni Skele 35/6kv;

Dhe gjithashtu për gjithë Bashkinë janë edhe nënstacionet e Smokthinë 35.10 kv; nënstacioni Gorisht 35/6kv

Në shumë zona, rrjeti është i vjetër dhe akoma punon në kushte teknike antike me 35 Kv për tensionin e 'lartë' dhe 10 Kv për tensionin e 'mesëm'. Si rezultat, për pasojë të vjetërsisë së rrjetit dhe nënstacioneve, sistemi pëson humbje të mëdha.

Njësia administrative Novoselë furnizohet me energji nga rrjeti 35/10kv ne Mifol

Telekomunikacioni Aktualisht ka një mbulim nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të Bashkisë. Përdorimi i kabllave optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen edhe nga operatorë të fuqishëm mobile si T-Mobile, Vodafone dhe Plus.

Mbetjet urbane. Vlora gjenerohen më shumë se 40000T/vit mbetje urbane dhe po aq afërsisht edhe mbetje inerte me një mesatare prej rreth 1.9kg mbetje/ditë/banor. Sot fusha e aviacionit mban afërsisht rreth 250 000m³ mbetje. Pavarësisht studimeve të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve gjendja mbetet problematike. Afërsia e pikës së grumbullimit të mbetjeve me qytetin e Vlorës është një problem akut që lidhet ngushtë me cilësinë e ajrit në zonë, me shëndetin e popullatës dhe zhvillimin e tij. Një zonë të nxehtë përbëjnë edhe mbetjet dhe ndotjet kimike në zonën e plazhit pranë ish-Uzinës e Sodë-PVC, (Vlerësimi i mërkurit dhe metaleve të rënda në biota, sedimente dhe tokën e lagunave të Nartës dhe Orikumit, raporti teknik i monitorimit Lazo, Çullaj, Baraj), e cila në vitet 1967-1992 ka shkarkuar drejtpërdrejt në det mbeturina e lëngëta (rreth 500 m³/orë) me përmbajtje të lartë mërkuri, rreth 1.1 mg/L me një total prej 64 ton. urizmit. Novosele. Grumbullimi i plehrave për gjithë fshatrat e njësive Novoselë depozitohet afër Lumit Vjosë. Novosela prodhon mbetje 15 ton /ditë. Për momentin problemi i mbetjeve të ngurta është zgjidhur me një rrjet kazanësh për hedhje mbeturinash dhe largimin e tyre në zonën e minierës së vjetër të Mushqetas. Problem shqetësues janë edhe mbetjet ndërtimore. Për momentin pjesa e dherave të nxjerrë nga gërmimet është zgjidhur nga vetë firmat e ndëritimit. Mbetjet industriale në këtë njësi janë të pakta. Në të ardhmen mbetjet do të depozitohen në landfildin e Sherishtës.

6.8 Plani i mbrojtjes së peizazhit

Peizazhi në zonë është një nga elementët parësor për t'u adresuar. Ndërhyrja artistike peisazhistike dhe infrastrukture jo vetëm për zonën në studim por për të gjithë kompleksin natyror Det-Lagunë është i domosdoshëm dhe i menjëhershëm. Duhet të merren masa për përmirësimin e peisazhit nëse autoritet lokale dhe qendrore por edhe palët e interesuar në zhvillimin e zonës, synojnë të arrijnë objektivat për zhvillimin e një ekonomie turistike vibrante dhe të qëndrueshme.

Investimet dhe Masat mbrojtëse për rikuperimin e peizazhit, që duhet të merren parasysh në çdo kohë, janë:

- Hartimi i një Plani peisazhistik që përfshin territorin nga Porti i Vlorës deri në grykëderdhjen e lumit Vjosa.
- Pyllëzimin e brezit bregdetar me Pisha dhe bimë lokale, së pari si një masë për ndaljen natyrale të erozionit dhe së dyti për të vazhduar rikuperimin e realizuar në ëaterfrontin e Vlorës.

- Dizenjimin e një sistemi bashkëkohorë infrastrukturor për kanalet kulluese, që të përballojë kapacitetin ujembledhës së zones dhe të sigurojë drenazhimin e fushes e cila është lehtësisht e permbytshme dhe për pasojë vështiresisht e përdorshme për ndërtim apo edhe aktivitet bujqësor.
- Hartimi i planit të zbatimit për Shëtitoren e bregdetare të zonës që lidh grykëderdhjen e lumit Vjosa me zonën e ishullit të Zvërnecit. Integrimi në të i minipiazzave që zbresin në det apo i shëtitoreve tëërthore ala Boulevard që krijojnë kone shikimi nga prapatoka drejt detit.
- Cdo projekt për aks rrugor të ri të shoqërohet me gjelbërim anësor në gjerësinë e buffer zonës.
- Zhvillimet e strukturave të reja dhe aktiviteti në zonë duhet të jetë konform të gjitha rregullave mjedisore dhe standardeve të kërkuara në dokumentet strategjike e mjedisore ku përfshihet zona (PINS Bregdeti dhe nga planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur natyrore);
- Strukturat duhet të evokojnë një arkitekturë origjinale me kërkesa estetike që orjentojnë drejt përdorimit të materialeve natyrore të zonës (guri dhe druri), dhe duhet të respektojnë maksimalisht peizazhin rrethues;
- Nuk lejohet prerja e pemëve ekzistuese;
- Duhet të sigurohet mbjellja e fidanëve të rinj në zonë, në përputhje me bimësinë autoktone;
- Ndërmarrja e iniciativave për ripërdorimin dhe riciklimin që në burim të mbetjeve si dhe diferencimin e tyre;
- Ndërmarrja dhe ndërtimi i sistemeve të posaçme për pastrimin e ujrave të përdorur me qëllim ripërdorimin e tyre në mënyrë që të mos kenë efekte mjedisore në zonë;
- Realizimi i sistemit të qarkullimit dhe të aksesit ekologjikisht të përshtatshme, për shfrytëzim turistik të organizuar të mjedisit natyror të lagunës së Nartës, Kripores dhe zonës së Zvërnecit. (rrugë këmbësoresh, objekte të vogla shërbimesh, pika vrojtimi shpendësh etj.).

6.9 Plani i veprimit për zbatimin e planit të detajuar - ndërtimi i infrastrukturave dhe shërbimeve publike.

Plani i Veprimit për zbatimin e PDZRK mbështetet në:

- Rolin e autoriteteve shtetërore për koordinim dhe monitorim të procesit të investimeve publike dhe private
- Mundësinë për bashkëfinancim të infrastrukturës publike midis institucioneve shtetërore dhe investorëve privatë
- Si edhe mundësinë për të koordinuar këto investime të përbashkëta si psh: infrastruktura e transportit rrugor, sistemimi i bregdetit me masa të buta mbrojtëse ndaj erozionit, pyllëzimit masiv sipas plan propozimit të PDZRK etj.

Skenari I

Fillimet e punimeve për ndërtimin e aeroportit mund të shënojnë Fazën e parë për zbatimin e planit dhe duhet shoqëruar bashkë me koordinimin e investimeve private për të realizuar infrastrukturën e primare, si psh rrugët e kategorive primare, ato që bëjnë ndarjen midis makro zonave funksionale të planit. Në këtë fazë sigurohet lënia e hapësirës së nevojshme për shtrimin e infrastrukturës nëntokësore të UKZ dhe linjat parësore të transmetimit të energjisë elektrike.


Faza e dytë sipas këtij skenari parashikon sistemimin e sistemit të kullimit të tokave bujqësore përreth. Ky hap jo vetëm ndihmon në konsolidimin e tokës që parashikohet për zhvillim në të ardhmen dhe mbron investimin madhor të aeroportit por gjithashtu kontribuon në shoqërinë lokale dhe përmirësimin e ekonomisë bujqësore të fshatrave ekzistuese.

Faza e tretë, shoqërohet me nisjen e investimeve të pavarura sipas zonave funksionale dhe mbahet e monitoruar nga institucionet shtetërore zbatimi i rregullave për mbrojtjen e mjedisit si edhe realizimi i kontributeve të investimeve private në infrastrukturën dhe hapësirat publike si psh: gjelbërimi pyllëzimi sipas PDZRK, i zonave përreth zonave të zhvillimit, lidhja e përshtatshme me infrastrukturën kryesore, monitorimi i mbetjeve dhe zhurmave sipas kushteve të studimit mjedisor si edhe mundësia për koordinimin e punimeve sipas një grafiku kohor që sinkronizohet me kërkesat e habitatit natyror ekzistues psh: në fazën e folezimit të shpendëve shtegëtar mund të ndalohen punime të cdo lloji karakteri dhe procesi i punës të vijojë në muajt e vitit që nuk përbëjnë rrezik për faunën e territorit.

Skenari II

Punimet e aeroportit dhe të investimeve private janë të pavarura. Në këtë skenar janë investimet private që nisin zbatimin e planit. Në këtë rast Faza e parë do të kërkonte koordinimin këtyre investimeve për infrastrukturën e kullimit të tokës dhe të zbatimit të masave mbrojtëse nga erozioni. Faza e dytë, fillojnë investimet sipas zonave. Në fazën e tretë, institucionet shtetërore mund t'i bashkohen me bashkëfinancim investimeve private për të realizuar infrastrukturën rrugore, UKZ dhe rrjetin e Energjisë Elektrike.

Në cdo rast, procesi i monitorimit nga autoritetet përkatëse për respektimin e rregullave dhe kushteve të mbrojtjes së mjedisit do të jetë i vazhdueshëm. Lejet e përdorimit nuk mund të bëhen efektive nëse nuk janë realizuar kushtet teknike për të shmangur cdo lloj ndotje të patrajtuar, në det apo në tokë.



Harta 11.Kufiri i PDZRK-së në raport me qytetin e Vlorës